

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6251
E shtunë, 27 shkurt 2021
çmimi 0.40 €

Adem Demaçi të lihet i qetë në amshim nga ata që nuk e kanë respektuar dhe vlerësuar sa ishte gjallë!

FAQE 10-11



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", SADRI FERATI | FAQE 4-5

KRYESIA E LDK-së NUK KISHTE ILAÇ PËR NDALJEN E RËNIES



Ish-zyrtari i lartë i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Sadri Ferati, ka vlerësuar se rënia e kësaj partie në zgjedhjet e 14 shkurtit nuk ka filluar në muajt e fundit. Në këtë

intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se kryesia e LDK-së asnjëherë nuk e kishte "ilaçin" për ta ndaluar trendin e rënies. Ferati ka thënë se janë disa faktorë që kanë çuar në turrjen e kësaj

partie. Ai ka treguar se do të ishte mirë që kjo parti të bëjë reforma të thella dhe t'i nisë zgjedhjet e brendshme. Mirëpo, sipas tij, këto duhet të nisin pas një analize të mirëfilltë

IKSHPK-ja REKOMANDON SHTRËNGIM TË MASAVE

Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka mbajtur të premtën takim me ministrin në detyrë të Shëndetësisë, Armend Zemaj, me përfaqësues të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), ku është bërë me dije se janë shënuar rritje të rasteve me Covid-19 në dy javët e fundit për



7.7 për qind. Sipas përfaqësuesve të IKShPK-së, rekomandohet rigorozitet i masave për ta ndaluar trendin e rritjes së rasteve me këtë virus | FAQE 3

KURTI, NË DITËN E LINDJES SË TYRE, BËN HOMAZHE TE VARRI I ADEM DEMAÇIT DHE ASTRIT DEHARIT | FAQE 6



OPINION

DITARI VETJAK I KADARESE

F. 12



Bedri ISLAMI

AKTUALE



LAJÇAKU VIZITON KOSOVËN F. 5

TAKOHEN HOTI DHE LIKAJ, DISKUTOJNË PËR MBARËVAJTJEN E PROCESIT MËSIMOR NË SHKOLLA F. 6

DREJTËSI JOEFTKIVE PËR SULMET NDAJ GAZETARËVE F. 7

EKONOMI



BURIM PIRAJ: KUVENDI I KOSOVËS TA MIRATOJË NJË LIGJ PËR PËRDORIMIN E LINJITIT F. 9

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS MBËSHTET REALIZIMIN E PROJEKTEVE INFRASTRUKTURE NË FERIZAJ F. 9

SPORT

BESA DHE PRISHTINA NDAJNË MEJDANIN NË PEJË F. 12

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Në Shkup protestohet kundër vendimit për rastin "Monstra"

SHKUP, 26 SHKURT - Të premten në Shkup është protestuar me moton "Drejtësi për Liri" kundër vendimit të Gjykatës Penale për rastin "Monstra". Protestuesit janë penguar nga kordoni i forcave policore të shkojnë para qeverisë për t'i paraqitur kërkesat e tyre ndaj autoriteteve zyrtare. Për pasojë, një pjesë e protestuesve ka hedhur gjësende të forta drejt pjesëtarëve të forcave të sigurisë.

Kryetari i Këshillit Organizativ të Protestave, Bedri Hajdari, ka thënë se policia mund të bllokojë rrugën, por jo edhe realizimin e drejtësisë, andaj ka kërkuar nga protestuesit të tregohen më gjakftohtë. "Kjo nuk është protestë ilegale. Këtu nuk ka njerëz kriminelë, njerëz provokues, por njerëz që duan drejtësi", ka deklaruar ai para protestuesve. Ai ka thënë se nuk do të ndalen protestat për të cilat në opinion ekzistojnë dyshime se janë të montuara siç është rasti "Monstra", që ka të bëjë me vrasjen e pesë personave pranë Liqenit të Smillkovës, në afërsi të Shkupit. Ai ka kërkuar nga

autoritetet qeveritare "ndërprerjen e pazareve politike në kurriz të shqiptarëve të pafajshëm, të publikohen të gjitha bisedat e përgjuara në lidhje me këtë rast dhe të përfshihet faktori ndërkombëtar gjatë procesit gjyqësor". "Kërkojmë të shkarkohet prokurorja dhe gjykatësit e rastit 'Monstra', sepse ata fare nuk u morën me faktet dhe provat që duhej të vinin nga bisedat e përgjuara të lidhura me këtë rast. Kërkojmë që kuvendi dhe qeveria t'i publikojnë bisedat e përgjuara me qëllim, që gjykimin e së vërtetës për këtë rast ta bëjë vetë opinioni publik, qoftë ai shqiptar, maqedonas apo cilido qoftë tjetër", ka thënë ai. Ai ka kërkuar edhe thirrjen e ekspertëve ndërkombëtarë që të bëjnë hetime në mënyrë të pavarur "të tipit të EULEX-it në Kosovë, që të merren me të gjitha rastet e montuara politike nga të cilat shqiptarët vuajnë burgje të rënda edhe pse janë të pafajshëm".

Ai beson se pas mospublikimit të bisedave të përgjuara, që lidhen me rastin "Monstra",

fshihen pazare politike mes strukturave të caktuara në Maqedoninë e Veriut. "Tani doli se bisedat nuk janë të kompletuara dhe se nuk janë dorëzuar apo nuk janë publikuar në tërësi nga ana e prokurorisë", ka thënë Hajdari për "Radion Evropa e Lirë". Pavarësisht se ka bërë thirrje që protestuesit të shpërndahen, një gjë e tillë nuk ka ndodhur, pasi ata kanë vazhduar të qëndrojnë në afërsi të udhëkryqit pranë kompleksit të gjykatave ku është vendosur kordoni i policisë.

Të martën Gjykata Penale e Shkupit ka dënuar me burgim të përjetshëm Alil Demirin si dhe vëllezërit Agim dhe Afrim Ismailoviq, të akuzuar për vrasjen e pesë maqedonasve më 12 prill 2012 pranë Liqenit të Smillkovës, rreth 12 kilometra nga Shkupi. Viktima ishin katër të rinj të moshës prej 18 deri 20 vjeç dhe një tjetër i moshës 44-vjeçare. Dy të akuzuarit e tjerë, Fejzi dhe Haki Aziri, gjykata i dënoi me 15 dhe nëntë vjet burgim. Një person tjetër, Sami Luta, është liruar nga akuza në mungesë të



provave. Ndaj vendimit të Gjykatës Penale për rastin "Mostra" kanë reaguar partitë politike shqiptare në opozitë, Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa, me ç'rast kanë kërkuar përfshirjen e faktorit ndërkombëtar. Zijadin Sela, kryetar i Aleancës për Shqiptarët, ka porositur kryeministrin maqedonas Zoran Zaev që mos ta harrojë deklarinimin e tij nga pozicioni i liderit të opozitës gjatë publikimit të bisedave të

përgjuara. "Ai sot është njeriu që ka harruar, po e citoj, 'njerëz të pafajshëm janë në burg për 'Monstrën'. E vërteta për 'Monstrën', ishte po ai (Zaevi) që thoshte, që është e tmerrshme. Ishte po ai i cili kishte me dhjetëra dhe qindra mijëra përgjime dhe me bindje fliste se ka fakte që njerëz të pafajshëm janë në burg" ka deklaruar Sela, i cili u ka dhënë përkrahje protestuesve. Protesta për rastin "Monstra" janë organizuar edhe të premten e 29 janarit.

Sasho Mijallkov dënohet me 12 vjet burgim

SHKUP, 26 SHKURT - Gjykata Penale e Shkupit ka dënuar me 12 vjet burgim Sasho Mijallkovin, ish-shefin e policisë sekrete të Maqedonisë së Veriut. Ai, së bashku me disa ish-bashkëpunëtorë, është shpallur fajtor për veprën penale "Bashkim kriminal", "Përgjime të paligjshme" dhe "Shkatërrim të pajisjeve për përgjim". Goran Grujevski dhe Nikolla Boshkovski, dy drejtues të lartë në Drejtorinë e Sigurimit dhe Kundërzbulimit, janë dënuar me nga 15 vjet burgim. Ndërsa ish-ministrja e Brendshme, Gordana Jankulovska, është dënuar me 4 vjet burgim, kurse Vlladimir Vallerov, Silvana Zlatkova dhe Vasil Isakovski, të gjithë punonjës në shërbimin

sekret, janë dënuar me nga 2 vjet burgim. "Të akuzuarit shpallen fajtorë për përgjim masiv të paligjshëm, me një qëllim të vetëm dhe motiv për të vendosur kontroll të plotë politik, ekonomik dhe kontroll të përgjithshëm në jetën e përditshme duke shkelur të drejtat elementare të njeriut. Viktimat, përkatësisht të dëmtuarit, janë politikanë, gazetarë, personalitete nga jeta politike ekonomike e biznesi që kanë ndikim në shoqëri. Ata kishin për qëllim të kishin kontroll mbi të gjithë, jo vetëm mbi kundërshtarët politikë, por mbi të gjitha ata që kanë ndikim, përfshirë edhe bashkëpunëtorët e tyre. Të gjithë përgjonin, madje nuk e



dinin nëse edhe vetë përgjoheshin", është thënë në aktvendimin e Gjykatës Penale në Shkup, duke treguar edhe se si janë kryer përgjimet. "Përgjimet janë kryer përmes pajisjeve dhe sistemit që ekzistonte në Ministrinë e Punëve të Brendshme për ndjekjen e komunikimeve, sisteme që duhet të shërbimin për sigurinë dhe të drejtat e qytetarëve dhe të shtetit në

përgjithësi. Këto pajisje ishin shkatërruar menjëherë pas informacioneve se bisedat e përgjuara tashmë ishin të kapshme për opinionin e gjerë me nisjen e publikimit të tyre duke i shkaktuar një dëm buxhetit të shtetit prej më shumë se një milion euro", është thënë në aktvendimin e Gjykatës Penale në Shkup. Në bazë të akuzës për rastin e koduar si "Target-Fortesa", Sasho Mijallkov, i cili ka qenë në krye të Drejtorisë për Siguri Kombëtare, ka përgjuar në mënyrë të paligjshme mbi 4 000 numra të telefonit, apo rreth 20 000 persona, pa pasur vendim gjyqësor për përgjime të tilla, raporton "Rel". Ish-drejtori i policisë sekrete

maqedonase, Sasho Mijallkov, të martën ishte dorëzuar në Prokurorinë e Shkupit për ta marrë vendimin e arrestit shtëpiak, pas dy ditë kërkimesh intensive nga policia, e cila shpalli edhe fletarrestim ndërkombëtar. Edhe pse Mijallkov ka thënë se është dorëzuar vetë, kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, tha se kjo është bërë e mundur falë angazhimit të policisë dhe personalisht vetë atij. Opozita ka kërkuar interpelancë për ministrin e Punëve të Brendshme të Maqedonisë së Veriut, Oliver Spasovski. Afera e përgjimeve ishte zbuluar në vitin 2015 nga Zoran Zaev, i cili atë kohë ishte në opozitë.

Rama: Pranverën do ta kthejmë në stinë vaksinimi kundër Covidit

BERAT, 26 SHKURT - Gjatë një bashkëbisedimi me qytetarët e Beratit, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka folur për çështjen e vaksinimit kundër Covidit dhe vështirësive të hasura për furnizimin me dozat e nevojshme. Ai ka shprehur besimin se në ditët në vijim mund të arrihet një marrëveshje për sigurimin e mijëra dozave vaksine gjatë

stinës së pranverës. "Çështja e vaksinës është kthyer në një çështje botërore. Të gjitha shtetet kanë nevojë për vakcina. 70 për qind e prodhimit të vaksinave është në duart e 10 shteteve. Dhe Shqipëria, si një vend i vogël, si një vend në një rajon në mes të Evropës, por që nuk u përfshi në skemën evropiane të shpërndarjes së vaksinave, ka një sfidë të madhe. Falë

këmbënguljes ne ia kemi dalë të nisim vaksinimin, ndërkohë që shumë shtete nuk kanë bërë gjilpërën e parë. Brenda gjysmës së parë të muajit mars do ta mbyllim vaksinimin e mjekëve dhe infermierëve. Jam besimplotë se së shpejti do të kemi lajme të mira për sigurimin e sasive të nevojshme për të mos ulur ritmin, por për ta shtuar atë



dhe për ta kthyer të gjithë këtë sezon pranveror në një sezon vaksinimi masiv", ka thënë Rama.

Pas fushatës zgjedhore, rriten rastet me Covid-19 për 7.7 për qind

IKShPK-ja rekomandon shtrëngim të masave

Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka mbajtur të premtën takim me ministrin në detyrë të Shëndetësisë, Armend Zemaj, me përfaqësues të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), ku është bërë me dije se janë shënuar rritje të rasteve me Covid-19 në dy javët e fundit për 7.7 për qind. Sipas përfaqësuesve të IKShPK-së, rekomandohet rigorozitet i masave për ta ndaluar trendin e rritjes së rasteve me këtë virus



EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 26 SHKURT - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, të premtën ka mbajtur takim me ministrin në detyrë të Shëndetësisë, Armend Zemaj, me përfaqësues të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës dhe të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës.

Në këtë takim është vlerësuar situata epidemiologjike me Covid-19 në Kosovë, e cila ka shënuar rritje të rasteve në dy javët e fundit për 7.7 për qind, me trend të rritjes në tri ditët e fundit të kësaj jave nga 320 raste në 422 raste në mesatare këtë javë (24,1 për qind).

Për këtë qëllim janë dhënë një mori rekomandimesh duke u bazuar në situatën epidemiologjike në vend, ku është theksuar nevoja që

inspektoratet sanitare të AUV dhe inspektoratet komunale ta zbatojnë në përpikëri Ligjin kundër Covidit, Ligjin për Inspektoratin dhe Ligjin për Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, si dhe të merren masa përgjegjësie në rast të moszbatimit eventual të rekomandimeve të IKShPK-së dhe MSH-së në të gjithë sektorët.

Sipas përfaqësuesve të IKShPK-së, rekomandohet rigorozitet i masave për ta ndaluar trendin e rritjes së rasteve me virus. Ndërsa sa iu përket vaksinave, Ministria e Shëndetësisë është duke pritur kontingjentin e parë të vaksinave dhe është e gatshme që, porsa të vijnë, të zbatohet strategjia e vaksinimit anti Covid-19 në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Gjatë këtij takimi kryeministri Hoti theksoi se institucionet përgjegjëse, përkatësisht Policia e Kosovës dhe inspektoratet përgjegjëse, do të

mbikëqyrin me përpikëri dhe do t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e masave dhe vendimeve të tjera në fuqi në zbatim të Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në Republikën e Kosovës.

Në fund të këtij takimi është përsëritur domosdoshmëria e zbatimit të rekomandimeve të IKShPK-së dhe respektimit të masave kufizuese për të gjitha aktivitetet publike, përkatësisht kufizimet për grumbullimin e qytetarëve dhe tubimeve publike.

Pesë raste të të vdekurve dhe 445 raste të reja me Covid në Kosovë

Gjatë 24 orëve të fundit në

Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 2 570 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 445 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar pesë raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Deçan një rast (78 vjeç), Gjilan një rast (78 vjeç), Kamenicë një rast (65 vjeç), Prishtinë një rast (76 vjeç) dhe Suharekë një rast (80 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 68 351 raste nga 300 198 persona të dyshimtë me këtë

virus dhe 1 592 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 264 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 59 438 raste, kurse numri i rasteve aktive është 7 321.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 179 raste, Gjakovë 39 raste, Pejë 37 raste, Prizren 29 raste, Gjilan 24 raste, Ferizaj 16 raste, Mitrovicë 14 raste, Fushë-Kosovë 13 raste, Lipjan 13 raste, Vushtrri 13 raste, Podujevë 12 raste, Rahovec 8 raste, Kamenicë 7 raste, Skenderaj 7 raste, Suharekë 7 raste, Drenas 5 raste, Dragash 4 raste, Istog 4 raste, Obiliq 4 raste, Graçanicë 3 raste, Deçan 2 raste, Kllokot 2 raste dhe me nga një rast komunat Klinë, Malishevë dhe Viti.

KFOR-i bën ushtrime me helikopterë në disa qytete të Kosovës

PRISHTINË 26 SHKURT (ER) - Misioni i KFOR-it, i udhëhequr nga NATO-ja, ka zhvilluar një trajnim në ajër me disa helikopterë, gjegjësisht me gjashtë helikopterë të kontingjentëve kroate, zvicerane dhe amerikane. Ushtrimi u përqendrua në standardizimin e procedurave të planifikimit dhe ekzekutimit të misionit, në testimin e fluturimit dhe komunikimit, dhe filloi nga Aeroporti Ushtarak në Sllatinë, duke vazhduar me kampin "Bondsteel", Prizren, Pejë, Aeroportin e Sllatinës dhe Prishtinë, dhe përfundoi në Shtabin e Përgjithshëm të KFOR-it në Kampin "Kosova Film".

Ky ushtrim ka siguruar që KFOR-i të mbetet një forcë e fuqishme ushtarake, e gatshme për të vepruar si parandalues i

besueshëm ndaj çdo kërcënimi dhe për të ruajtur kapacitetet e tij për të kryer fluturime të evakuimit urgjent mjekësor kurdo që nevojitet. "Misioni i KFOR-it, i udhëhequr nga NATO-ja, është kontingjent shumëkombësh me 27 vende anëtare të NATO-s dhe shtetet partnere. Ky dimension ndërkombëtar ofron kapacitete dhe kompetenca të ngritura. Kërkohej trajnim dhe ushtrim i vazhdueshëm për t'u siguruar se të gjitha kontingjentet veprojnë në mënyrë të standardizuar, duke siguruar aftësinë e KFOR-it të reagojë në përputhje me Rezolutën 1244 të OKB-së dhe në mënyrë të shpejtë dhe efikase nga ajri dhe nga toka ndaj çdo sfide për mjedisin e qetë dhe të sigurt dhe lirinë e lëvizjes", ka njoftuar KFOR-i.





FLET PËR “EPOKËN E RE”, SADRI FERATI

Kryesia e LDK-së nuk kishte ilaç për ndaljen e rënies

Ish-zyrtari i lartë i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Sadri Ferati, ka vlerësuar se rënia e kësaj partie në zgjedhjet e 14 shkurtit nuk ka filluar në muajt e fundit. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se Kryesia e LDK-së asnjëherë nuk e kishte ilaçin për ta ndalur trendin e rënies. Ferati ka thënë se janë disa faktorë që kanë çuar tkurrjen e kësaj partie. Ai ka treguar se do të ishte mirë që kjo parti të bëjë reforma të thella dhe t’i hapë zgjedhjet e brendshme. Mirëpo, sipas tij, kjo duhet të bëhet pas një analize të mirëfilltë

për ta ndalur trendin e rënies. Pavarësisht prej veprimeve të arsyeshme politike, ky është edhe perceptim. Siç po shihet, kryesia e LDK-së nuk e ka pasur asnjëherë ilaçin se si të ndalet trendi i rënies së votës së LDK-së”, ka thënë Ferati.

Ai ka thënë se kjo parti tani është para dy dilemave. “Ka mendime të ndara në parti. Fillimisht të bëhet ndryshimi i kryesisë, pastaj kryesia e re të dalë me politika apo të shkohet në zgjedhje të reja të brendshme”, është shprehur ai. Sipas Feratit, rruga më e mirë do të ishte zgjedhjet e reja brenda partiake. “Dëshira e të gjithëve

është që të shkohet në një reformë më të thellë por, para se të ndodhë kjo, duhet të ketë një analizë. Në këtë gjendje të lëvizjes së elektoratit së pari duhet të evidentohet elektorati, sepse tani nuk je i sigurt se kush do të marrë pjesë në zgjedhje nëpër degë e nëndegë. Pra, e dëshirueshme është që të ndodhë reforma e plotë, megjithatë në këtë gjendje ka dilema”, ka deklaruar ai.

Ferati ka folur edhe për ndikimin e Vjosa Osmanit në rezultatin e zgjedhjeve të 14 shkurtit. Ai ka bërë me dije se më herët ka pasur mundësi që kryesia e LDK-së dhe Vjosa

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 26 SHKURT - Ish-zyrtari i lartë i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Sadri Ferati, ka thënë se rezultatin e zgjedhjeve të 14 shkurtit nuk e kanë pritur

as skeptikët më të mëdhenj brenda partisë. Ai ka treguar se në këtë rënie kanë ndikuar disa faktorë. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Ferati ka thënë se kryesia e LDK-së asnjëherë nuk e ka pasur ilaçin e ndaljes së trendit të

rënies së LDK-së. “Në këtë rezultat mendoj se ka ndikuar shumëçka. Rënia e rejtingut të LDK-së nuk është e muajve të fundit. Ajo ka filluar më herët. Në parti nuk kanë pasur një analizë se çfarë po ndodh dhe cilat veprime duhet të bëhen



Osmani ta gjejnë një gjuhë të përbashkët. “Me fajin apo pa fajin e LDK-së dëmi nga largimi i saj është i madh. Vjosa nuk ka dalë vetëm, por ka dalë me një pjesë të elektoratit. Ne nuk mund ta masim se sa elektorat ka shkuar pas saj, por rezultati prej 13-përqindësh të bën të besosh se një pjesë e konsiderueshme e elektoratit ka pasur simpati dhe ka shkuar pas Vjosës në listën e LV-së. Në këtë drejtim, mendoj se më herët ka pasur vend që të ketë një qëndrim më ndryshe të kryesisë e cila do ta ndryshonte qëndrimin dhe sjelljen e Vjosës dhe nuk do të kishte ardhur gjendja deri këtu. Definitivisht kjo është një pasojë”, ka thënë Ferati.

“Epoka e re”: Z. Ferati, në zgjedhjet e 14 shkurtit LDK-ja ka shënuar rezultat shumë të dobët. Pse?

Ferati: Rezultati përfundimtar është shumë më i ulët sesa kemi pritur dhe parashikuar. Edhe skeptikët më të mëdhenj brenda LDK-së nuk e kanë paraparë këtë rezultat. Pra, rezultati i zgjedhjeve të 14 shkurtit është tepër i ulët dhe jashtë çdo analize që kemi pasur.

“Epoka e re”: Çfarë ka ndikuar në këtë rezultat?

Ferati: Në këtë rezultat mendoj se ka ndikuar shumëçka. Rënia e rejtingut të LDK-së nuk është e muajve të fundit. Ajo ka filluar më herët. Në parti nuk kanë pasur një analizë se çfarë po ndodh dhe cilat veprime duhet

të bëhen për ta ndaluar trendin e rënies. Pavarësisht prej veprimeve të arsyeshme politike, ky është edhe perceptim. Siç po shihet, kryesia e LDK-së nuk e ka pasur asnjëherë ilaçin se si të ndalet trendi i rënies së votës së LDK-së. Së dyti, menaxhimi jo i mirë i zgjedhjeve të brendshme e ka lënduar procesin zgjedhor, ku disa prej degëve i ka dobësuar tepër shumë. Së fundi, edhe çështja e adresimit me kuadro nuk ka qenë shumë adekuate.

“Epoka e re”: Cila duhet të jetë përgjigja e LDK-së ndaj këtij rezultati?

Ferati: Tanimë veç e kemi një përgjigje. Kryetari ka paralajmëruar se do të japë dorëheqje. Tani pritja është nëse do të shkohet me ndryshime dhe reforma vetëm në kryesi dhe pastaj të shkohet ngadalë nëpër degë apo të shkohet me një proces të reformimit të thellë, pra në zgjedhje të reja.

“Epoka e re”: Sipas jush, cila do të ishte rruga më e mirë?

Ferati: Më shumë jam ithtar i asaj që të shkohet komplet në zgjedhje të reja. Mirëpo, siç po shihet, një proces i tillë nuk do të jetë i lehtë për faktin se zgjedhjet lokale i kemi afër. Pra, ka mendime të ndara në parti që fillimisht të bëhet ndryshimi i kryesisë dhe pastaj kryesia e re të dalë me politika apo të shkohet në zgjedhje të reja të brendshme. Si njëra rrugë ashtu edhe tjetra mund të jenë paralajmërim i ndryshimeve.

Pastaj duhet të ketë një komunikim më të qartë edhe si opozitë, sepse edhe roli opozitar tregon një aftësi të caktuar. Pra, edhe kur je në pushtet dhe kur je në opozitë duhet t'i demonstrosht aftësitë e caktuara dhe duhet të kesh komunikim me qytetarët.

“Epoka e re”: Meqenëse jeni për reforma më të thella, shpallja e zgjedhjeve të brendshme, sa do ta ndihmonte LDK-në për zgjedhjet lokale?

Ferati: Dëshira e të gjithëve është që të shkohet në një reformë më të thellë por, para se të ndodhë kjo, duhet të ketë një analizë. Në këtë gjendje të lëvizjes së elektoratit së pari duhet të evidentohet elektorati, sepse tani nuk je i sigurt se kush do të marrë pjesë në zgjedhje nëpër degë e nëndegë. Pra, e dëshirueshme është që të ndodhë reforma e plotë, megjithatë në këtë gjendje ka dilema.

“Epoka e re”: Nëse do të ketë zgjedhje të reja brenda LDK-së, a do t'i hyni ju garës për kryetar të degës?

Ferati: Nuk po them se unë do të hyj në këtë proces, por gjithsesi nuk do të jem indiferent. Pra, sigurisht se ndihmën time do ta jap.

“Epoka e re”: Ndikim të madh në këtë rënie të LDK-së po shihet se ka pasur edhe largimi i Vjosa Osmanit. Mendoni se kryesia e LDK-së gaboi me sjelljen ndaj saj?

Ferati: Mendoj se para se të ndodhte ftohja e raporteve, ka pasur vend që të ulen dhe të

hapin një debat të brendshëm, pra ku do të dëgjohej zëri i secilit.

Me fajin apo pa fajin e LDK-së dëmi nga largimi i saj është i madh. Vjosa nuk ka dalë vetëm, por ka dalë me një pjesë të elektoratit. Ne nuk mund ta masim se sa elektorat ka shkuar pas saj, por rezultati prej 13-përqindësh të bën të besosh se një pjesë e konsiderueshme e elektoratit ka pasur simpati dhe ka shkuar pas Vjosës në listën e LV-së. Në këtë drejtim mendoj se më herët ka pasur vend që të ketë një qëndrim më ndryshe të kryesisë e cila do ta ndryshonte qëndrimin dhe sjelljen e Vjosës dhe nuk do të kishte ardhur gjendja deri këtu. Definitivisht kjo është një pasojë.

“Epoka e re”: Pas paralajmërimit për dorëheqje të Isa Mustafës, kemi parë shumë zyrtarë të LDK-së që kanë shprehur ambicie për të qenë kandidat për kryetar të LDK-së. Si i keni parë këto veprime?

Ferati: Këto pretendime janë normale. Është e natyrshme të kemi disa pretendime në një proces demokratik brendapartiak. Madje mendoj se edhe në të kaluarën është dashur të lejohen më shumë kandidatura për postin e kryetarit. Vetë fakti se në të dyja herët e fundit kryetari është zgjedhur pothuajse me aklamacion, kjo ka treguar një dobësi të sistemit, apo frikësim nga vota e fshehtë ose një demonstrim të dominimit i cili për mua nuk është në rregull.

Lajçaku viziton Kosovën

PRISHTINË, 26 SHKURT - Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian për Dialogun Prishtinë - Beograd, Miroslav Lajçak, do ta vizitojë Kosovën nga 1 deri më 3 mars, ka konfirmuar Zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë përmes një komunikate për media. Pas Kosovës, ai do ta vazhdojë vizitën në Serbi, nga 3 deri me 4 mars, gjithashtu do ta vizitojë Malin e Zi si pjesë e mandatit të tij rajonal nga 4 deri në 5 mars. Lajçak planifikon të takohet me udhëheqjen politike të të tre partnerëve të Ballkanit Perëndimor, si dhe me përfaqësuesit e Bashkimit Evropian në terren. Bashkimi Evropian, në reagimet e para pas zgjedhjeve në Kosovë më 14 shkurt, ka bërë thirrje që autoritetet e reja që do të dalin nga këto zgjedhje ta vazhdojnë angazhimin konstruktiv në dialogun me Serbinë. Fituesja e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, Lëvizja Vetëvendosje (LV), ndonëse nuk e ka caktuar si prioritet dialogun

me Serbinë për normalizimin e marrëdhënieve, thotë se ky dialog, megjithatë, duhet të ketë qasje të re. Në këtë qasje, ndër të tjera, kërkohet edhe përfshirja e Shteteve të Bashkuara.

LV-ja në vazhdimësi e ka cilësuar dialogun e ndërmjetësuar nga Brukseli si jotransparent dhe i ka cilësuar si të dështuara shumicën e 33 marrëveshjeve të nënshkruara në Bruksel.

Kandidati i LV-së për kryeministër, Albin Kurti, ka thënë se dialogu është ‘prioritet i gjashtë apo i shtatë’, gjë e cila nuk është pritur mirë në BE. Zyrtarët e këtij institucioni, që e ndërmjetësojnë dialogun, nuk janë përgjigjur saktësisht në pyetjet e Radios Evropa e Lirë, nëse BE-ja është e gatshme ta ndryshojë qasjen në dialog, por kanë kërkuar angazhim për ta përmbyllur marrëveshjen për normalizimin e raporteve ndërmjet dy vendeve.

Nën ndërmjetësimin e BE-së, dialogu midis Kosovës dhe Serbisë ka nisur më 2011. Pas



një pauze 20-mujore, dialogu rinisi në korrikun e vitit 2020. Takimi i fundit i udhëheqësve të

Kosovës dhe Serbisë u zhvillua në shtatorin e vitit të kaluar. Deri në zgjedhjen e Qeverisë së

re të Kosovës, Brukseli zyrtar ka paralajmëruar se nuk do të ketë takime në kuadër të dialogut.

Policia mban ligjërata në shkolla për parandalimin e përdorimit të substancave narkotike

PRISHTINË, 26 SHKURT (ER) - Policia e Kosovës, gjegjësisht Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim në kuadër të aktiviteteve parandaluese dhe vetëdijësuese, më 22-26 shkurt 2021 ka zhvilluar disa aktivitete përmes ligjëratave në shkolla të mesme dhe në shkollat e mesme të ulëta në Komunën e Podujevës. Me kërkesë të Stacionit Policor të Podujevës dhe me koordinim të Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe drejtorëve të shkollave, ligjëratat janë mbajtur

kryesisht për temën "Substancat narkotike dhe pasojat e tyre" dhe janë zhvilluar në shtatë shkolla (tri shkolla të mesme dhe katër shkolla të mesme të ulëta). "Interesimi ka qenë mjaft i madh për pjesëmarrje duke pasur bashkëbisedim mes policisë, nxënësve dhe arsimtarëve se si duhet mbrojtur veten, parandaluar dhe raportuar këtë dukuri të dëmshme shoqërore. Pjesëmarrja e nxënësve në këto ligjërata për gjithsejtë pesë shkolla arrin 230 nxënës", është thënë në komunikatën e



Policisë së Kosovës. Sipas kësaj komunikate, në

kuadër të këtyre aktiviteteve do të vizitohen edhe dy

shkolla të tjera për të përfunduar kështu organizimin vetëdijësues të koordinuar dhe mbështetur nga Stacioni Policor i Podujevës. "Policia e Kosovës është gjithnjë e gatshme të bashkëpunojë në mënyrë që të rinjtë t'u shmangen dukurive negative që ndikojnë keq në shoqëri. Zyrarët nga kjo drejtori kanë ligjëruar duke respektuar udhëzimet dhe masat bazuar në manualin dhe rekomandimet e IKShPK-së", është theksuar në komunikatën e Policisë së Kosovës.

Kurti bën homazhe te varri i Adem Demaçit dhe Astrit Deharit në ditën e lindjes së tyre



PRISHTINË, 26 SHKURT (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, bashkë me disa anëtarë të partisë së tij, kanë bërë homazhe të premtën te varri i Adem Demaçit dhe Astrit Deharit, në ditën e lindjes së tyre. Kurti dhe delegacioni i prirë nga ai kanë vendosur lule te varret e tyre. "Astrit Dehari dhe Adem Demaçi

kanë sot ditëlindjen. Kosova, në mes të Luftës së Dytë Botërore dhe pavarësisë, nuk mund të kuptohet pa Demaçin, ndërsa Kosova e pas pavarësisë dhe deri në ardhmëri nuk mund të kuptohet pa Astritin. Njëri e kuptimëson më shumë tjetrin, i pari të ardhmen në histori, i dyti historinë në ardhmëri. Sot i gëzojmë ditëlindjet e tyre,

ashtu siç presim t'i gëzojmë përplot ditë në Kosovën tonë përmes punës e angazhimit që motivohet nga këto dy figura. Për nder të tyre, një delegacion i prirë nga kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh kryeministri në ardhje, Albin Kurti, bëri sot homazhe dhe vuri lule të freskëta te varret e tyre", ka njoftuar Vetëvendosja.

Më 14 mars LDK-ja pritet ta zgjedhë kryetarin e ri

PRISHTINË, 26 SHKURT (ER) - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) do ta mbajë kuvendin zgjedhor më 14 mars. Në këtë kuvend zgjedhor do të zgjedhet kryetari i ri i partisë, si dhe organet e tjera drejtuese të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Këtë e ka bërë me dije sekretari organizativ i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Arban Abrashi, në një konferencë për media, pas mbledhjes së kryesisë së partisë. Abrashi ka thënë se tashmë janë bërë publike disa kandidatura por, sipas tij, ato zyrtarizohen më 14 mars, ditën kur zhvillohet kuvendi zgjedhor.

Pak kohë pas publikimit të

rezultateve preliminare të zgjedhjeve të 14 shkurtit, kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, njoftoi për dorëheqje nga drejtimi i partisë. Në një letër të gjatë, Mustafa dha arsyet e dorëheqjes së tij. Në zgjedhjet e 14 shkurtit LDK-ja garoi me Avdullah Hotin kandidat për kryeministër. Në këto zgjedhje ky subjekt politik, sipas rezultateve preliminare, fitoi vetëm 13.08 për qind. Pas publikimit të rezultateve preliminare, Hoti tha se merr përgjegjësinë për rezultatin e dobët të LDK-së. Në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2019, LDK-ja kishte fituar rreth 24 për qind të votave.



Takohen Hoti dhe Likaj, diskutojnë për mbarëvajtjen e procesit mësimor në shkolla

PRISHTINË, 26 SHKURT (ER) - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të premtën në takim ministrin në detyrë të Arsimit dhe Shkencës (MASH), Ramë Likaj, ku është informuar lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor në shkolla, përgatitjet për përmbylljen e vitit shkollor, organizimin e testit të maturës dhe testit të arritshmërisë, mënyrën e organizimit të mësimit online dhe çështjen e akreditimit të

institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre studimore. Ministri në detyrë, Ramë Likaj, ka theksuar se mbarëvajtja e procesit mësimor është duke u mbikëqyrur në vazhdimësi nga ana e inspektorëve të arsimit, në mënyrë që ky proces të realizohet sipas planit të MASH-it. Ndër të tjera, është diskutuar lidhur me gjendjen e krijuar në arsimin para universitar të

Komunës së Kamenicës si pasojë e mosvijimit të procesit mësimor nga nxënësit e disa shkollave. Likaj e ka informuar Hotin edhe rreth procesit të përmbylljes së obligimeve që ka Ministria e Arsimit dhe Shkencës për anëtarësim në ENQA si dhe situatës së krijuar pas dorëheqjes së tre anëtarëve ndërkombëtarë dhe dy anëtarëve vendorë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC).



PRISHTINË, 26 SHKURT - Më 13 qershor të vitit 2020, në qytetin e Mitrovicës, Shkumbin Kajtazi, gazetar i portalit online "Reporter.net", derisa po qëndronte në një kafiteri të qytetit, është ftuar nga zyrtarët e Policisë së Kosovës, me njoftimin se nga persona të dyshuar ka pasur një tentim për t'ia djegur veturën.

Siç rrëfen për "Radion Evropa e Lirë" gazetari Shkumbin Kajtazi, policia dhe prokurori kujdestar kishin shkuar në vendin e ngjarjes, ku kanë parë se mbi veturën e tij ishte hedhur benzinë, por që të dyshuarit nuk kishin arritur t'ia vinin flakën.

Hetimet për këtë rast, sipas Kajtazit, kishin vazhduar dhe tashmë prokuroria ka ngritur aktakuzë ndaj një personi. Por, ky ishte vetëm sulmi i parë ndaj pronës së këtij gazetari.

Sërish, më 18 tetor të vitit 2020, në qytetin e Mitrovicës, vetura e Shkumbin Kajtazit ishte sulmuar, por kësaj radhe me armë zjarri. "Unë kam dëgjuar të shtëna, mirëpo nuk e kam menduar që janë në drejtim të veturës sime. Kur kam dalë të vetura, kam parë se janë të paktën pesë vrima. Pastaj janë gjetur edhe plumbat. Dyshohet se është shtënë me një armë që nuk lejon që të dalin gëzhojat dhe se është shtënë nga një veturë. Do të thotë, gëzhojat nuk janë gjetur në vend të ngjarjes, por janë gjetur vetëm predhat, pjesët e plumbave", ka rrëfyer Kajtazi.

Sulmet ndaj gazetarit Shkumbin Kajtazi, sipas Besim Kelmendit, prokuror nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, janë në mesin e mbi 35 rasteve të paraqitura gjatë vitit 2020 në prokurori si sulme dhe kërcënime ndaj gazetarëve. "Prej tyre, janë ngritur aktakuzat për pesë raste. Për 14 raste nuk kanë filluar fare procedurat penale për shkak se gazetarët nuk i kanë paraqitur rastet në polici apo në prokurori ose, thjesht, prokurori nuk ka gjetur elemente të veprës penale. Ndërsa për 17 raste të tjera, procedurat janë në verifikim të informatave. Për disa ka filluar hetimi dhe pritet përfundimi i tyre dhe, pastaj, të dihet fati se a do të ngrihen aktakuza apo do të pushohen hetimet. Vetëm një rast është nga gjykata, që është marrë vendimi, do të thotë aktgjykimi, për rastet që janë paraqitur në vitin 2020", ka thënë prokurori Kelmendi për "Radion Evropa e Lirë".

Më 22 dhjetor të vitit 2020, në Prishtinë, në mes të rrugës ishte sulmuar fizikisht gazetari Valon Syla, drejtor i portalit "Metro". Gjykata Themelore e Prishtinës, më 8 janar, ka bërë me dije se e ka dënuar sulmuesin e tij, me inicialet B. J., me gjobë prej 4 500 eurosh.

Gentiana Begolli, kryetare e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, thotë për Radion Evropa e Lirë se rastet e kërcënimeve dhe të sulmeve, qoftë verbale, qoftë fizike, ndaj



Drejtësi joefektive për sulmet ndaj gazetarëve

gazetarëve janë në rritje e sipër. Këtë e argumenton, sipas saj, numri i rasteve të paraqitura në AGK, në tre vjetët e fundit kalendarikë. "Në vitin 2018 në AGK janë evidentuar 17 raste, për të cilat AGK-ja ka reaguar. Në vitin 2019 janë evidentuar 21 raste. Më 2020 janë shënuar 24 raste. Tash për tash, në dy muajt e parë të vitit 2021, janë evidentuar gjithsej 2 raste", thotë Begolli.

Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, në një bisedë me Radion Evropa e Lirë, konsideron se përderisa në të kaluarën ndaj gazetarëve kanë ekzistuar vetëm kërcënime përmes rrjeteve sociale apo formave të ndryshme, tashmë publiku është dëshmitar që gazetarët sulmohen në rrugë, rrahën dhe përgjaken. Sulmet ndaj gazetarëve, sipas tij, nga rastet e izoluar kanë nisur të kthehen në fenomen. "Vetë fakti që brenda vitit ngrihen pesë aktakuza për sulme që tashmë janë kthyer në fenomen ndaj gazetarëve dhe ndaj aktorëve të shoqërisë civile, tregon mosvullnetin për t'i trajtuar këto raste me prioritet. Kujtoj se gjykatat nuk është se u japin rëndësinë e duhur këtyre rasteve. Në bazë të asaj që ne i kemi monitoruar proceset gjyqësore, dënimet për sulmet ndaj gazetarëve janë kryesisht me kusht ose me gjobë. Kjo e përcjell mesazhin e sistemit të drejtësisë të të gjithë ata që potencialisht rrahin ose kërcënojnë gazetarët, se këtë mund ta bëni sërish, sepse sistemi i drejtësisë, thjesht, me mosveprim do t'i amnistojë", thekson Miftaraj.

Sulmet ndaj gazetarëve, fenomen?

Rasti i fundit i sulmit fizik ndaj një gazetari në Kosovë është

shënuar në natën ndërmjet 24 dhe 25 shkurtit të sivjetmë në Fushë-Kosovë. Visar Duriqi, gazetar i portalit online "Insajderi", është sulmuar fizikisht nga tre persona të panjohur dhe, për pasojë, i janë thyer dhëmbët dhe hunda. Lidhur me këtë rast, Policia e Kosovës ka thënë se është duke i zhvilluar hetimet, ndërsa rastin është duke e shqyrtuar edhe Prokuroria e Shtetit.

Duriqi i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se personat që e kanë sulmuar kanë qenë të maskuar dhe me kapelë. Megjithatë, ai ka shprehur mendimin se sulmet fizike ndaj gazetarëve në Kosovë nuk janë fenomen. "Mendoj se më shumë janë raste të izoluar, sikurse ky rasti im, sesa raste sistematike, pra që cenohet liria e shprehjes. Liria e shprehjes më shumë cenohet prej grupeve të interesit, nëpërmjet aspekteve financiare, marketingut, tendencës për të ndikuar financiarisht, sesa që ne si gazetarë në Kosovë kemi rrezik permanent prej sulmeve. Pra, deri më tash mendoj se, përfshirë edhe rastin tim, sulmet më shumë janë raste të izoluar sesa që janë fenomen", ka theksuar Duriqi.

Por, mendim tjetër ka drejtuesja e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, Gentiana Begolli. Shifrat e rasteve të evidentuara të kërcënimeve dhe sulmeve verbale dhe fizike ndaj gazetarëve, në vitet e fundit, sipas saj, flasin për një fenomen i cili po shkon duke u rritur. "Nuk do të thosha se janë raste të izoluar, marrë parasysh që këto janë vetëm disa nga statistikatat që kanë arritur në Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës. Ne e dimë shumë mirë që ka shumë kolegë tanë të cilët madje nuk i raportojnë rastet e kërcënimeve apo sulmeve të ndryshme. Kjo gjithnjë, duke u bazuar në veprimin shumë të ngadalshëm

të organeve të drejtësisë dhe në shumë raste dënimet shumë të vogla ndaj keqbërësve, sulmuesve apo kërcënuesve", ka thënë Begolli. Edhe prokurori Besim Kelmendi shpreh mendimin që rastet e kërcënimeve dhe sulmeve verbale dhe fizike ndaj gazetarëve nuk mund të konsiderohen si të izoluar për shkak se këto raste bëjnë pjesë në kapitullin e veprave penale kundër jetës dhe trupit. Sipas tij, "çdo kanosje, sado e lehtë që duket në fillim, mund të paraqesë rrezik për jetën e gazetarit", prandaj shqyrtohet, siç thotë ai, "me vëmendje të madhe nga të gjithë prokurorët".

Prokuroria, e pakënaqur me gjykatat

Megjithatë, prokurori Kelmendi thotë se Prokuroria e Shtetit nuk është e kënaqur me vendimet e gjykatave. Sipas tij, edhe për prokurorinë, disa prej rasteve që paraqiten brenda një viti, kërkojnë më shumë veprime për të marrë dëshmitarë dhe për të ardhur deri te provat e ndryshme për shkak se, siç thotë ai, nuk dihen identitetet e atyre që kryejnë vepra penale ndaj gazetarëve. "Ndërsa, për rastet kur dihet identiteti (i sulmuesit) dhe ekzistojnë provat, është e patolerueshme që të bëhen vonesat në procedura, ndonëse Kodi i Procedurës Penale e ka paraparë një afat prej dy vjetësh, e në raste të ndërlukuara edhe 6 muaj, me lejen e gjykatës. Por, në rastet e gazetarëve, shumë rrallë ka nevojë të shtyhet ky afat, kur dihet identiteti i atyre që kanë kryer veprat penale", theksoi prokurori Kelmendi. Por, gazetarët që kanë qenë cak i sulmeve dhe kërcënimeve, si dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, kritikant për mosefikasitet në trajtimin ligjor të rasteve të

kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve, më shumë i orientojnë në adresë të prokurorisë.

Kajtazi: Pas sulmit, prokuroria nuk më ka kontaktuar

Gazetari Shkumbin Kajtazi, vetura e të cilit u sulmua dy herë në Mitrovicë, thotë se për rastin e parë është ngritur një aktakuzë, por nga prokuroria ai ishte kontaktuar tre muaj pas rastit. Ndërkaq, për rastin e dytë, kur në veturën e tij është shtënë me armë zjarri, ai fare nuk është kontaktuar nga prokuroria.

"Me policinë kam pasur kontakt, sidomos për rastin e dytë. Policia më ka ofruar një lloj mbrojtjeje. Mirëpo, për rastin e dytë, prokuroria as që ma ka kontaktuar dhe as nuk e di se kush është prokurori i rastit. Po bëhen tash diku afër pesë muaj prejse ka ndodhur rasti dhe unë nuk e kam marrë asnjë telefonatë prej prokurorisë", ka theksuar Kajtazi.

Për aspektin e ndjekjes penale, Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, po ashtu fajëson prokurorinë. Për më shumë, sipas tij, "në shumicën e rasteve, Prokurori i Shtetit është shumë selektiv në hetimin e këtyre veprave penale".

Ai këtë e bazon edhe në përvojën e institutit që përfaqëson, i cili, sipas tij, ka dërguar edhe prova në prokurori për kërcënimin e gazetarëve. "Përderisa policia ka filluar hetimet, prokurori, thjesht, e ka mbyllur rastin me arsyetimin se nuk ka elemente të mundshme të veprës penale. Do të thotë, pa e marrë fare në pyetje gazetarin dhe pa e marrë fare në pyetje personelin e Institutit të Kosovës për Drejtësi. Prokuroria është fajtoare kryesore. Gjykatën e fajësoj vetëm kur shpall dënime me kusht. Kur dështojnë aktakuzat, ka faj prokurori dhe jo gjykatat, sepse duhen fakte dhe prova për ta ndërtuar aktakuzën. Në përvojën time dhe të shumë gazetarëve, prokuroria nuk të fton fare. E mbyll (rastin) pa të thirrur fare", u shpreh Miftaraj.

Pas sulmit ndaj gazetarit Visar Duriqi kanë reaguar drejtues të institucioneve të larta të vendit, të partive politike dhe përfaqësues të shoqërisë civile, duke e dënuar ashpër dhe duke e cilësuar si të papranueshëm. Ata u kanë bërë thirrje organeve të rendit dhe të drejtësisë që kryesit e veprës penale t'i gjejnë dhe t'i nxjerrin para drejtësisë. Por, Miftaraj ka theksuar se thirrjet e tilla mund të jenë vetëm klishe, në rast se nuk do të ketë një përgjigje të duhur nga sistemi i drejtësisë. Në të kundërtën, sipas tij, ekziston droja që Kosova së shpejti mund të hyjë në listën e zezë të shteteve që nuk i mbrojnë gazetarët.

Nisin procedurat e shpronësimit të segmentit rrugor Gjakovë në drejtim të Pejës

GJAKOVË, 26 SHKURT (ER) - Të premtën është mbajtur mbledhja e dytë për vitin 2021 e Kuvendit të Komunës së Gjakovës në të cilën janë shqyrtuar dhe janë votuar të gjitha pikat e rendit të ditës të propozuara nga kryesuesi i kuvendit, Anton Shala dhe kryetari i komunës, Ardian Gjini. Me propozim të kryetarit Gjini, si pikë e veçantë ka hyrë dhe është miratuar unanimisht propozimi për nisjen e procedurave të shpronësimit në segmentin nga qendra e qytetit deri në dalje të qytetit në drejtim të Pejës. Nevoja për shpronësim vjen pas nënshkrimit të memorandumit në mes të kryetarit Gjini dhe ministrit të Infrastrukturës,


Arban Abrashi, për fillimin e punimeve për zgjerimin e rrugës hyrëse në këtë segment. Ndërsa sipas propozimit të kryesuesit Shala, janë shqyrtuar dhe miratuar propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e fushës së futbollit në fshatin Korenicë, plani i punës së KKS-së për vitin 2021, raporti i punës për ndërmarrjet publike komunale "Stacioni i Autobusëve" dhe "Çabrati".

Nga ana e përfaqësuesve të Drejtorisë për Punë Inspektuese është dhënë informata për shqiptimin e gjobave për mosrespektimin e Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 gjatë fushatës elektorale.



Komuna e Gjilanit nënshkruan memorandum me Islamic Relief Kosova

GJILAN, 26 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka nënshkruar të premtën një memorandum mirëkuptimi me organizatën Islamic Relief Kosova për mbështetje ndaj familjeve bujqësore.



Haziri e ka falënderuar këtë organizatë për mbështetjen. Ai ka bërë me dije se programi i sotëm është në kuadër të programit për ta zhvilluar familjen bujqësore. "Me mbështetje të Islamic Relief Kosova, në kuadër të programit për bujqësinë, do ta vazhdojmë subvencionimin. Kjo është marrëveshja e parë që ne e realizojmë me këtë organizatë, por me besim të madh që do të

vazhdojmë ta rritim programin sepse përfitues të drejtpërdrejtë janë familjet bujqësore. Programi i sotëm është në kuadër të programit të familjes që ne e kemi, për ta zhvilluar familjen bujqësore", ka deklaruar Haziri.

Menaxherja e projekteve në Islamic Relief Kosova, Albulena Gashi, e ka falënderuar kryetarin

Haziri dhe drejtorin Ramadani për fillimin e bashkëpunimit, duke uruar që ky projekt t'u ndihmojë familjeve gjilanasë.

Drejtori i Bujqësisë në Gjilan, Ramiz Ramadani, ka thënë se marrëveshja do të implementohet në përpikëri, duke njoftuar se nga ky projekt përfitojnë 40 familje perimtare, që nënkupton 40 serra, 37 familje përfitojnë nga një lopë të racës simental, derisa 40 familje përfitojnë nga 30 krerë pula.

Vlera e këtij projekti është 160 mijë euro, ku Islamic Relief Kosova participon me 65 për qind, ndërsa Komuna e Gjilanit me 35 për qind.

Agjencia për Zhvillim Rajonal konfirmon bashkëpunimin me Komunën e Drenasit

DRENAS, 26 SHKURT (ER) - Drejtoresha e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Drenasit, Egzona Jetullahu, ka pritur të premtën në takim drejtoreshën e Agjencisë për Zhvillim Rajonal - Qendër, Mrikë Gashi-Macula, me të cilën ka diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit edhe në të ardhmen në mënyrë që të rinjtë e Drenasit të përfitojnë nga këto bashkëpunime të suksesshme. Gashi-Macula ka falënderuar



Jetullahun për bashkëpunimin e deritashëm dhe biseduan për projektet e ardhshme. Po ashtu, në këtë takim u diskutua edhe për projektet me të cilat Komuna e

Drenasit planifikon të aplikojë në ministritë e ndryshme dhe ta vazhdojë bashkëpunimin me donatorët, gjithmonë në shërbim të qytetarëve.

Ndërron jetë Fatime Haxhidema, një nga të plagosurat në shpërthimin në Ferizaj

FERIZAJ, 26 SHKURT (ER) - Ka ndërruar jetë Fatime Haxhidema, një nga të lënduarat për shpërthimin e bombolës së gazit në restorantin në Ferizaj që ndodhi muajin e kaluar. 20-vjeçarja më 7 janar ishte nisur për t'u trajtuar në Turqi, por që nga plagët e marra nuk arriti të mbijetojë.

Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka ngushëlluar familjen Haxhidema. "Me dhembje të thellë sot mora

lajmin për ndarjen nga jeta të bashkëqytetares sonë Fatime Haxhidema e cila ishte e lënduar nga shpërthimi i fillimvitet në njërin nga restorantet e Ferizajt dhe po trajtohej në shërbimin e specializuar mjekësor në Turqi. Sot jemi të gjithë të lënduar, të gjithë me familjen e të ndjerës. Ferizaj humbi një bashkëqytetare, familja më të shtrenjtën familjare e shoqëria e saj, një mike të çmuar", është shprehur Aliu në telegramin ngushëllues të kryetarit Aliu.



Komuna e Malishevës do t'i ndihmojë tri familje për rinovimin e shtëpive

MALISHEVË, 26 SHKURT (ER) - Kuvendi Komunal i Malishevës ka mbajtur të premtën mbledhje në të cilën është diskutuar për çështje të ndryshme në arsim, infrastrukturë rrugore, kanalizim, ndriçim dhe për qentë endacakë.

Kuvendi Komunal i Malishevës vendosi t'i ndihmojë tri familje të cilat i rekomandoi komisioni për rinovim të shtëpive. Po në këtë mbledhje u bë edhe shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së tretë urgjente të vitit 2020,

shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2020, shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës për vitin 2020 të Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteran të Luftës së UÇK-së si dhe Martir të Luftës.



Burim Piraj: Kuvendi i Kosovës ta miratojë një ligj për përdorimin e linjtit

Pronari i kompanisë “Meka Halal Food”, Burim Piraj, ka theksuar se në vendin tonë duhet të funksionojë liberalizimi i tregut të energjisë në mënyrë që afarizmi të mos përballet me sfidat e ndërprerjes së energjisë elektrike. Ai ka thënë për gazetën “Epoka e re” se Kosova duhet ta miratojë ligjin për linjit njëlloj si shteti gjerman



në lidhje me përdorimin e linjtit për prodhim të energjisë elektrike, pastaj të shpallet tender ndërkombëtar dhe me siguri do të ketë qindra firma të interesuara për të investuar në ndërtimin e TC në Kosovë”, ka thënë Burim Piraj, pronar i kompanisë “Meka Halal Food”.

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 SHKURT - Pronari i kompanisë “Meka Halal Food”, Burim Piraj, ka thënë se në Kosovë duhet të funksionojë liberalizimi i tregut të energjisë në mënyrë që afarizmi të mos përballet me sfidat e ndërprerjes së energjisë elektrike. Meqë Kosova ka rezerva të mëdha të linjtit, ai ka thënë se Kuvendi i Kosovës duhet ta miratojë një ligj për linjtin dhe më pas ta bëjë hapjen e një tenderi ndërkombëtar për të investuar dhe shfrytëzuar këto rezerva konform standardeve. Piraj ka thënë për gazetën “Epoka e re” se liberalizimi i tregut të energjisë siç është në Bashkimin Evropian do t'i evidentonte ndërprerjet e energjisë elektrike. “Kosova është një vend shumë i vogël dhe nuk do të thotë se patjetër duhet të ketë prodhim të vetin

të energjisë elektrike, vetëm se duhet të liberalizohet tregu i energjisë elektrike ashtu siç është në Bashkimin Evropian. Pastaj kurrë nuk do të ketë mungesë të energjisë elektrike, edhe pse KEDS-i nuk ka bërë investime të nevojshme në rrjet. Kështu që, për shkak të prishjeve, mund të ketë herë pas here mungesë të energjisë në regjione të ndryshme”, u shpreh ai.

Ndërkaq sa i përket shfrytëzimit të linjtit, Piraj ka propozuar që Kosova ta miratojë ligjin për linjit ashtu si shteti gjerman. “Po kthehem te TC. Në Evropë janë tri shtete që e shfrytëzojnë linjtin për prodhim të energjisë elektrike: Gjermania, Polonia dhe Greqia. Prandaj pse Kosova mos ta bëjë të njëjtën gjë. Mendoj se dështimi ka të bëjë me implikimin e politikanëve në zhatje për përfitime materiale. Propozimi im do të ishte që Kuvendi i Kosovës ta miratojë ligjin aktual gjerman

Gërzhaliu: Që të rimëkëmbet ekonomia duhet të sigurohet unitet politik



PRISHTINË, 26 SHKURT - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërzhaliu, ka thënë se që të rimëkëmbet ekonomia në Kosovë, fillimisht duhet të sigurohet një stabilitet i cili çon në unitet politik. Ai ka thënë për “Ekonomia Online” se qeveria në ardhje duhet të jetë e fokusuar në tri aspekte. E para ka të bëjë me vaksinimin, e dyta me rimëkëmbjen ekonomike, e treta është zgjedhja e kuadrove të duhura në funksion të zgjidhjes së këtyre problemeve. “Vetëformimi i qeverisë së re

dhe kabinetit qeveritar nuk është një shkop magjik që do t'i zgjidhë problemet e grumbulluara nga e kaluara. Vërtet ka shumë sfida dhe shumë probleme që kërkojnë angazhim për t'u zgjidhur. Në këtë drejtim besoj se efekti i parë që duhet të reflektohet është uniteti dhe stabiliteti politik. Për fat të keq, deri më tani nuk kemi pasur në Kosovë një stabilitet politik i cili do të jetë në funksion të zgjidhjes së problemeve dhe besoj se ky duhet të jetë prioritet”, ka thënë Gërzhaliu.

Ministria e Infrastrukturës mbështet realizimin e projekteve infrastrukturore në Ferizaj

PRISHTINË, 26 SHKURT (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, të premten ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me kryetarin e Komunës së Ferizajt, Agim Aliu. Përmes kësaj marrëveshjeje dypalëshe, mundësohet asfaltimi i rrugës Talinoc i

Muhaxherëve - Rahovicë. Ministri Abrashi ka theksuar vendosmërinë e tij për t'i dalë në ndihmë secilës komunë për realizimin e projekteve infrastrukturore, të nevojshme për lëvizje të qytetarëve. MI-ja është financuese e këtij projekti i cili do të bëhet në faza të

ndara, përderisa dokumenti specifikon edhe përgjegjësitë komunale drejt realizimit të saj. Ky është një nga shumë investimet infrastrukturore të parapara nga Ministria e Infrastrukturës për vitin 2021, në pothuajse të gjithë komunat e Republikës së Kosovës.





ADEM DEMAÇI TË LIHET I QETË NË AMSHIM NGA ATA QË NUK E KANË RESPEKTUAR DHE VLERËSUAR SA ISHTE GJALLË!



**Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA**

A ishte Baca Adem kundër Ibrahim Rugovës: Për Bacën Adem Demaçin, si Shpirt i Pamposhtur dhe Sakrifikues, deri në Vetëflijim për Liri, Çlirim dhe Bashkim Kombëtar, kam dëgjuar sikur edhe të gjithë shqiptarët e tjerë për shkak të mbajtjes në burg në llogoret e ish-Jugosllavisë për 28 vjet e që e cilësuan si

Mandela i Evropës ndonëse, nëse kemi parasysh kohëzgjatjen dhe kushtet e vuajtjes së dënimit në ish-Jugosllavi, Mendela do të duhej të cilësohej si Adem Demaçi i Afrikës së Jugut. Adem Demaçi u arrestua dhe u dënua fillimisht për një mendim politik të shprehur në romanin "Gjarprinjtë e gjakut" që u bë doracak i asaj kohe, por edhe i mëvonshëm për të gjithë shqiptarët që e donin lirinë dhe bashkimin kombëtar. Me qindra dhe mijëra shqiptarë u frymëzuan nga ky roman e që pastaj përfunduan në burg, si të burgosur politikë, martirë dhe, së fundi, edhe si dëshmorë

dhe heronj të Ushtrisë së Lavdishme Çlirimtare të Kosovës. Adem Demaçi e kreu burgun në kushte jashtëzakonisht të rënda, sidomos në Llogorin e Stara Gradishkës, ku qëndroi thuaja 15 vjet dhe ku e dërguan që të mos kthehej i gjallë. Edhe unë vitin e parafundit të dënimit kam qenë në Llogorin e Stara Gradishkës dhe e kam parë se në çfarë kushte e ka vuajtur dënimin Baca Adem Demaçi në kohën kur qarkullonin zëra, kryesisht nga shqiptarët, se Adem Demaçi nuk është në burg, por në ndonjë hotel. Baca Adem Demaçi nuk ishte në burg shkak se kishte bërë

ndonjë organizim të qartë parashtarak apo ushtarak (sikur që e kishte bërë Nelson Mendela) dhe se përdorte dhunë, por për shkak të lirisë së fjalës, idesë së qartë politike për bashkim kombëtar dhe bashkim me Shqipërinë që mbështetej në një program të qartë politik. Gjatë tërë kohës sa ishte aktiv në politikë e që nënkupton thuaja tërë jetën, ishte vijues i përcaktimit politik dialektik dhe që mbështetej në mundësitë që i kishin shqiptarët, rrethanat e brendshme dhe faktori ndërkombëtar mirëpo, asnjëherë nuk hoqi dorë nga përcaktimi që e kishte për liri,

çlirim dhe bashkim kombëtar. Më vonë, bashkë me Ahmet Haxhiun dhe disa shokë të besueshëm ishte angazhuar për themelimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilën e mbrojti edhe në kohën kur Gelbarti e quajti terroriste, kurse shumica e politikanëve në Kosovë e pritën me duartrokkitje këtë cilësim të Gelbartit. Platforma politike "Ballkania" ishte kurth që Baca e bëri për Serbinë e që e kishte të qartë se do të sulmohej nga një krah impotent i politikanëve të Kosovës të cilët nuk e lëviznin prapanicën pa shikuar nga Beogradi. "Ballkania" e Bacës Adem



Demaçi ishte shumë më afirmative dhe domethënëse se pavarësia e mbikëqyrur që e kishte Kosova dhe në disa pjesë ishte më e përparuar se Kosova sot që 30 për qind të territorit, ndonëse e pavarur, e ka nën kontroll të Beogradit, ndërsa nuk ka sovranitet të plotë as në territorin që e kontrollon. Por për atë kohë ishte herezi të dilje kundër qëndrimeve “politike” të disa politikanëve kosovarë e që i kishin shërbyer besnikërisht Jugosllavisë dhe Serbisë dhe i kishin rënë mritzit. Po të njëjtët reagues edhe kur në skenë doli Ushtria Çlirimtare e Kosovës, duke e mohuar atë, në vend se ta përkrahnin. “Ballkania” ishte përpjekje për t’i ikur luftës në atë kohë. Baca Adem sulmohet edhe për kundërshtimin e Marrëveshjes së Rambujesë dhe askush nuk e përmend faktin se çfarë do të ndodhte sikur Serbia ta nënshkruante këtë Marrëveshje në të cilën nga 12 pika, 8 prej tyre ishin të panegociueshme dhe, po të nënshkruante Serbia, Kosova do ta kishte statusin më të ulët se autonomia e vitit 1974. Kjo nuk përmendet. Do të ishte interes për publikun, sidomos të rinjtë që Albin Kurti ta tregojë bisedën dhe ofertën që i

kishte bërë Robin Kuk, atëherë ministër i Punëve të Jashtme i Mbretërisë së Bashkuar, në Shkup, më duket në hotelin “Alexandar Pallace”, si kusht për të shkuar në Rambuje. Albini ka qenë bashkë me Bacën Adem. Është interesant fakti që edhe për Rambujenë, kryesisht në kontekst të kundërshtimit, sot shkruajnë ata që ishin në Partinë Parlamentare të Kosovës e që një pjesë e tyre kanë përfituar nga të gjitha klasat politike të pasluftës e që duan të përfitojnë edhe nga kjo që po vjen. Në kohën kur, me të drejtë Baca Adem e kundërshtoi Marrëveshjen e Rambujesë, pati përkrahje vetëm nga Albin Kurti, Milot Cakaj dhe Skender Kastrati sikur që edhe Fexhrije Shala dha dorëheqje nga kryesia e Partisë Parlamentare në përkrahje të Bacës Adem Demaçi. Bajram Kosumi dhe Bujar Dugolli u kacavirren për aeroplan që çonte në Rambuje, prandaj edhe nuk mund të kishin qëndrim të prerë. Albin Kurti bëri përpjekje ta bindë Bujar Dugollin që të mos shkojë në Rambuje por Bujari, që sot po e përkrah me aq pasion, as që ia vari. Ka edhe shumë gjëra të tjera që do të thuheshin më vonë, nëse Zoti më jep jetë. Sot Adem Demaçin e sulmojnë kinse për mungesë të mendimit dhe sensit politik, ose injorantët e certifikuar, përfituesit e luftës dhe të pasluftës apo ata që personalisht apo familjarisht, jo që nuk kanë bërë asgjë për shqiptarët dhe Kosovës, por që i kanë shërbyer qençe ish-Jugosllavisë dhe Serbisë.

Si i përjetuan të burgosurit politikë shqiptarë zhvillimet e vitit 1989 në Llogorin e Stara Gradishkës: Të burgosurit, pavarësisht a janë të veçuar apo në vetmi, e kanë të zhvilluar jashtëzakonisht shqisën për t’i ndier ndryshimet që ndodhin jashtë, pavarësisht prej mungesës së informatave. Kjo vërehet në ndryshimin e sjelljes së gardianëve të burgut, personelit drejtues, administratës si edhe vetë të burgosurve, të dënuar për vepra jopolitike. Në Llogorin e Stara Gradishkës për ata që punonin kishte mundësi të informoheshin nga shtypi sikur edhe nga TV, ndërsa me porosi dhe një pagesë, një inxhinier i elektros kroat e bëri në radio të vogël që e maskoi në kuti të sapunit dhe të cilën, kohën më të madhe e kishte Baca Adem që i dëgjonte lajmet nga BBC, RFI, Zëri i Amerikës, Radio Dojçe Velle, Radio Tiranën dhe

stacionet e tjera jugosllave dhe kroate pasta, në brifingun e mëngjesit na informonte për zhvillimet e fundit. Lexohej shumë: Mlladina, Nedelna Dallmacija, Veçernji List, Nasha Borba, Politika si dhe revistat NIN dhe Danas. Lexonim edhe gazetatat në gjuhën shqipe kur na binin në dorë. Një kohë e kisha unë transistorin dhe brifingun e mëngjesit e filloja me: “të gjitha këto të arritura i kemi falë Partisë së Punës së Shqipërisë dhe shokut Enver Hoxha...” e që e thosha me shpoti për faktin se të gjithë e dinin që nuk kisha aspak qëndrim të mirë për shokun Enver Hoxha. Atëherë e dëgjuam emrin e Ibrahim Rugovës falë konferencave në Uzhiçka 5 në Lidhjen e Shkrimtarëve të Serbisë ku Rugova, Rexhep Qosja, Milazim Krasniqi dhe të tjerët mbronin me dinjitet çështjen kombëtare. Ishin protestat e studentëve dhe greva e minorëve. Ne si të burgosur u solidarizuar me grevën e minorëve duke bërë grevë urie edhe në Llogorin e Stara Gradishkës. Aty Baca Adem na tha se ky njeri (Ibrahim Rugova) duhet të përkrahët me tërë forcën se, më në fund, doli një udhëheqës shqiptar që e mbron dhe përfaqëson interesin kombëtar. Dhe, Baca Adem e ka përkrahur Rugovën deri në fillim të luftës. Nuk ka formuar parti politike pasi ka dalë nga burgu pikërisht që të mos shkaktojë përçarje dhe ta dëmtojë Rugovën. Ka kërkuar nga të burgosurit politikë të mos hyjmë në LDK sepse, siç thoshte Baca, jemi me shenjë si të burgosur dhe mund ta dëmtojmë lëvizjen popullore. Vetë ka votuar për Ibrahim Rugovën dhe ka kërkuar nga ne që edhe ne ta votojmë, një pjesë, në mesin e tyre edhe unë, edhe e kemi votuar. Nga Rugova ka kërkuar aktivizëm dhe marrje të përgjegjësisë në kohën kur lufta ishte e pashmangshme. Këtu ishte vija ndarëse midis Adem Demaçit dhe Ibrahim Rugovës. Adem Demaçi angazhohej për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar dhe për këtë e kishte vënë peng jetën e tij, çdo sekondë. Adem Demaçi ishte sakrifikuq që më nuk do të ketë të tillë në mesin e shqiptarëve. Edhe Ibrahim Rugova, pa asnjë dyshim e donte lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, sidomos në fazën e vonshme, por se nuk ishte në gjendje të sakrifikoje asgjë për këtë. Ishte tipik intelektual butak që nuk merr përgjegjësi. Adem Demaçi kurrë nuk ka deklaruar se Ibrahim Rugova

ishte tradhtar, madje ka kërkuar edhe nga të tjerët që mos ta thonë këtë cilësim. Po të merrte përgjegjësi për udhëheqje të luftës së UÇK-së Ibrahim Rugova e që, si president i takonte ta bënte këtë, Baca Adem Demaçi asnjëherë nuk do t’i ndahej Rugovës dhe kurrën e kurrës nuk do t’i bëhej konkurrent për asnjë post. Kjo është e vërteta, shumë shkurtimisht.

Baca Adem Demaçi e refuzoi Rambujenë dhe kishte plotësisht të drejtë. Nuk mund të pritej nga një sakrifikuq bibliq siç ishte Adem Demaçi që e sfidoi një shtet siç ishte Jugosllavia duke kaluar afërsisht 30 vjet në burgje dhe duke e mohuar veten krejtësisht, ta pranojë një Rambuje që, po të nënshkruhej nga Serbia, sot Kosova do ta kishte autonominë më të vogël se ajo e vitit 1974 e që do të garantohej nga bashkësia ndërkombëtare. Rambujeja nuk ishte sukses pse ne e nënshkruam, por shkak se Serbia nuk e nënshkroi. Llogaritje e gabuar e Millosheviqit dhe fat historik për Kosovën dhe shqiptarët.

Gjatë bombardimeve, kur shumica ikën nga Kosova, Baca Adem nuk e lëshoi Prishtinën përkundër faktit se guerilët e UÇK-së e siguruan se do ta nxirrnin nga qyteti. Baca Adem Demaçi çdo ditë ka dalë në qytet duke e sfiduar policinë që ta vrasë. Pasi u ktheva në Prishtinë, Baca ma tregoi një çantë që e merrte me vete kur dilte në qytet në të cilën ishte një sopatë - sakicë e dorës. Më tregoi se kishte vendosur që do ta përdorte në vetëmbrojtje ndaj çdo polici. Mirëpo regjimi i Serbisë ishte i kujdesshëm dhe saktësisht e parashikoi se nëse do të vriteshin Adem Demaçi dhe Ibrahim Rugova, dëmi do të ishte shumë më i madh se dobia. Ndryshe, kur do të donin do t’i vrisnin, edhe Adem Demaçin si dhe Ibrahim Rugovën, i kishin në duar dhe i mbikëqyrnin 24 orë. Madje, shikuar nga ky aspekt, e them se edhe Adem Demaçi si dhe Ibrahim Rugova kanë qenë nën mbrojtje të pahetueshme.

Deklarimi i Rrahman Paçarizit, se “në kohën kur Ibrahim Rugovën e kanë dërguar dhunshëm në Beograd dhe e kanë detyruar të dalë në një konferencë për shtyp, ku tha çka tha kurse, po në të njëjtën kohë Adem Demaçi sillej lirisht nëpër Prishtinë...” është dashakeq, i qëllimshëm dhe infantilizëm intelektual. Adem Demaçi e ka sfiduar jetën çdo sekondë të jetës dhe nuk e ka

njohur, për veten e tij shprehjen frikë, as edhe si shprehje e lëre më si ndjenjë. Adem Demaçi, me dëshirën më të madhe do të shkonte në Beograd, do të dilte para mediave dhe do të kërkonte që bombardimet e NATO-s ta vazhdojnë me gjithë potencialin. Këtë e kanë pasur të qartë autoritetet serbe andaj nuk ia kanë dhënë atë mundësi. Është antologjike, si për kah guximi ashtu edhe për kah qëndrimi politik, intervistat e Bacës Adem që i ka dhënë në mediat në Beograd dhe ballafaqimi me Vuk Drashkoviçin, kryeqetnikun e atëhershëm në Serbi. Në kohën e një lirie siç e kemi, në shprehje vijnë gjysmëvlerat dhe ndryshku njerëzor, kombëtar dhe moral. Për ta vlerësuar Adem Demaçin, duhet të keni një të kaluar që është afërsisht me mendimin dhe qëndrimin politik si dhe aktivitetin kombëtar të Adem Demaçit. Sot, përmes Adem Demaçit, duan të faktorizohen ata që asgjë nuk kanë bërë për këtë vend dhe që sakrificat më e madhe e tyre ka qenë se janë detyruar ta pinë një kokakola, pa akull. Po këta horra dhe ndryshke morale, duan ta mbjellin një rivalitet midis Adem Demaçit dhe Ibrahim Rugovës, që të dy tashmë të vdekur, që të dy me një qëllim, por se kanë pasur rrugë të ndryshme për arritjen e atij qëllim. Prandaj, është tejet e pamoralshme përpjekja për faktorizim dhe përfitim, loja me dy personalitete që janë shtyllat kryesore, i pari që nga vitet e '60 e derisa ka vdekur, Baca Adem Demaçi dhe i dyti, nga viti 1989 e deri në fillim të luftës së lavdishme të së lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës në krye me komandantin legjendar, të pavdekshmin dhe të papërsëritshmin Adem Jashari.

Baca Adem, në Ditëlindjen Tënde e që është edhe ditëlindja dhe kuptimi i lirisë për shqiptarët si dhe të përpjekjeve të pandërprera për bashkim kombëtar, një grup shokësh duam ta urojmë këtë ditë të bekuar nga Zoti duke vënë lule mbi shtëpinë tënde të përjetshme dhe të amshueshme. Me respekt krenar dhe mirënjohës që na dhe rastin të jemi me ty, por edhe borxhlinj që nuk e bëmë atë që e kishte qëllim Ti dhe të gjithë që u sakrifikuam: Tahir Hani, Nuhi Ahmeti, Elmi Reçica, Avdullah Dërguti, dr. Haki Gashi, Behxhet, Fexhrije, Shkëmb dhe Blin Shala. Respekt, deri në kohën kur do të bëhemi bashkë!

KADARE DHE KOSOVA (5)

DITARI VETJAK I KADARESË

Bedri ISLAMI

Ditari vetjak i Kadaresë, mbajtur gjatë ditë të Konferencës së Rambujesë, dëshmon për ankthin e tij, mërinë ndaj ngrehalucëve, zemërim për doktrat që dëgjon, ankth për çfarë do të ndodhë dhe, në një çast pagjumësie e zemërimi, shpërthen "Kosova për disa është tmerr, për disa është dhimbje, kurse për disa vazhdon të jetë biznes".

"Kosova ndërkaq e lënë në mëshirën e fatit mezi mbahet në këmbë. Bisha serbe e ka zënë për gryke dhe po e mbyl". Dhe pastaj, shënimi i shkruar pas mesnatës së 22 shkurtit: "Ndonëse kam rënë të fle në një e gjysmë, në tre të natës më del gjumi. Kam një parandjenjë të keqe. Kam bindjen se gjithçka po merr rrokullimën. Shqiptarët nuk dalin dot nga kurthi ku janë futur. Kosova po merr fund.

Ç'mund të bëhet ende? Koha që ka mbetur është shumë e shtrënguar. Duhet diçka e ngutshme".

Kadare bën dy gjëra. Ideja e Letrës drejtuar Delegacionit shqiptar në Rambuje i vjen natyrshëm. Është e vetmja zgjidhje. Një letër që t'i zgjojë nga gjumi. Që t'u kujtojë se ç'janë duke bërë. Që t'i detyrojë të harrojnë rapsodin e katundit...

Në orën katër letra është gati. Më në fund mund të bjerë të fle.

Nuk është e mjaftueshme vetëm kjo. Përmes mikut të tij të vjetër, Ekrem Bardha, takohet me Kris Hill, një darkë e përbashkët. Thujse familjare. Diplomati amerikan, njohës i shkëlqyer i Kosovës, shkon me vonesë dhe ankthi se mos diçka e mbrapshtë ka ndodhur në atë kështjellë të vjetër, rritet. Më në fund Hill është aty, së bashku me gruan. Ambasadori i njohur është i lumtur që takohet me shkrimtarin e shquar, Kadare është në ankth për të ardhmen. Dhe befas gjithçka lehtësohet. Kris Hill u thotë në afërsi, çka ende nuk mund të thuhet në publik, se, jo larg, makineria serbe do të bombardohet nga strukturat e NATO-s. Është ndër të parët që merr vesh një gjë të ëndërruar dhe për të cilën, për herë të parë i kishte shkruar Presidenti francez, Zhak Shirak. Ndjenja e të pamundshmes është larguar. Perëndimi, përfundimisht, do jetë pjesë e Ëndrrës.

Pak vetë e dinë, ndoshta edhe vetë Albin Kurti, nuk e di se lirimi i tij nga burgjet serbe ka lidhje edhe me angazhimin e Ismail Kadaresë. Disa ditë para se presidenti francez Zhak Shirak do të vizitohet Beogradin, dy vite pas përfundimit të luftës, Ismail Kadare i shkruan mbi fatin e të burgosurve shqiptarë në burgjet serbe. Lufta ka mbaruar, por qindra, ndoshta mijëra shqiptarë janë ende të burgosur, nën dhunën e përditshme dhe drojën e eliminimit.

Shkak për ringritjen e çështjes

është bërë një letër e të burgosurit politik Besim Zymberi, i cili, askush nuk e di se si e ka nxjerrë nga burgju, i drejton Kadaresë. Askujt tjetër, asnjë institucioni shqiptar, kudo qoftë ai. Vetëm Kadaresë. Letra është nënshkruar edhe nga qindra të burgosur të tjerë politikë. Besim Zymberi i ka kërkuar publikisht këtë dëshmim, si shkrimtar, duke kërkuar t'ia bëjë të ditur opinionit evropian dhe atij botëror.

Nuk është hera e parë që Kadare ka ngritur çështjen e të burgosurve politikë shqiptarë. Në vitin 1997 ai i është drejtuar Ministrisë së Jashtme franceze, e cila, me 21 maj 1997, i përgjigjet se "Zotëri i dashur, Letra juaj lidhur me çështjen e z. Ukshin Hoti ka angazhuar gjithë vëmendjen tonë...".

Dy nga presidentët më të shquar francez, Miteran dhe Zhak Shirak, janë ndër mikpritësit e tij, me të cilët ka zhvilluar një dialog të gjatë dhe shkëmbime letrash. E di se Franca, vendi i lirisë dhe i të drejtave qytetare, nuk do të mund të heshtë ndaj asaj që po përgatitet apo që ndodh në Kosovë.

Është krejt e mundshme që, mendja e shkrimtarit, që njeh e rrok krejt mirë historinë, të ketë jetë përpjekur të zgjojë pikërisht ndërgjegjen e një kombi, që në histori, shpesh herë, ka qenë i lidhur me shtetin serb, si një kumbar i tij.

Me 26 gusht 1998, në ankthin e asaj që do të ndodhë në Kosovë, por edhe i vetëdijshëm se Kosova nuk mund të zgjidhë e vetme tragjizmin që po i përgatitet dhe gjencidin që po ndodh, Kadare do të marrë përsipër një rol që, nga pozita e tij institucionale është tej limitit të tij, por nga institucioni që ai vetë ka ngritur e që i përket emrit të tij, është i përligjur.

Mes të tjerave ai i shkruan Presidentit francez Zhak Shirak. "Unë ju drejtohem juve, zoti president, duke i bërë thirrje ndërgjegjes suaj njerëzore, në tagrin që ju jep detyra e lartë e drejtimit të këtij vendi të madh, që është edhe atdheu im i dytë, që të bëni diçka të ngutshme dhe energjike, për të ndaluar këtë krim. Kur viktima thërret për ndihmë, asnjë arsye shtetërore, asnjë konventë, asnjë shkak tjetër, asnjë moral nuk mund të justifikojë mëdyshjen. Populli shqiptar i Kosovës është sot viktima që e ka thikën në fytyrë. Në emër të tij, unë ju drejtohem, me shpresë dhe besim se do të më kuptoni".

Përgjigja e presidentit francez është e menjëhershme. "I dashur Mjeshtër", i shkruan presidenti francez. "Koncepti juaj, lidhur për detyrimet e Francës, përputhet me imazhin që kam unë për vendin tim. Idetë e lirisë dhe të tolerancës, që frymëzojnë këtë vend, i japin zërit të tij një jehonë universale në mbarë botën..." Dhe befas, mes rreshtave është një premtim i presidentit francez, krejt i hapur, i drejtpërdrejtë, që nuk ishte



ndeshur më parë në letërkëmbimet e tjera me burrështetas. Është folur shpesh se kur e ku nisi ideja e përdorimit të armëve, e ngritjes së strukturave të NATO-s për të ndaluar gjencidin në Kosovë, shkatërrimin e një populli fisnik, cili ishte njeriu që dha i pari këtë mendim? Në cilin forum të NATO-s, në cilin takim të burrështetasve euroatlantikë, cili ishte shkaku madhor, ishte gjendje emocionale e çastit apo gjithçka ishte rrjedhojë e mendimit të pjekur politik që më herët në disa kancelari ndërkombëtare?

Kjo enigmë, që më pas u bë gjithnjë e më e qartë, ka pasur një fillësë.

Në letrën e presidentit francez Zhak Shirak, drejtuar shkrimtarit Ismail Kadare, për herë të parë, krejtësisht hapur, do të jetë premtimi se, "Por, nëse zëri i arsyes nuk arrin të bëjë atë që duhet, atëherë do të duhet përdorimi i armëve, për të bërë armët të heshtin. Atëherë, Franca do t'i kërkonte Këshillit të Sigurimit t'i jepte të drejtë NATO-s, për të ndërhyrë me të gjitha mjetet e nevojshme".

Është fillim shtatori i vitit 1998, shtatë muaj më pas, premtimi i Presidentit dhënë shkrimtarit, do të jetë realitet.

Zhak Shirak i drejtohet në letërkëmbimin e tij me Kadarenë, "i dashur mjeshtër" dhe kjo ndjenjë e përbashkët respekti, i ka hapur rrugën Kadaresë për të ngulmuar.

Dhe me 12 dhjetor 2001, ai i shkruan:

"Zoti president, siç e dini, kjo nuk është hera e parë që unë përpikem të tërheq vëmendjen tuaj ndaj çështjes së të burgosurve politikë shqiptarë të Kosovës.

E di që gjatë vizitës suaj në Beograd, u lirua vetëm një i burgosur, Albin Kurti. Por, sa të tjerë, numri i të cilëve nuk dihet, mbeten ende? Sa kanë vdekur? Kohë pas kohe, i zhvendosin nga një kamp në tjetrin, lirojnë një a dy vetë... Mes tyre mund të gjendet Ukshin Hoti, lider i rëndësishëm...".

Kadare dhe Ukshin Hoti

Mbrëmë, deri pas mesnatës, po lexoja librin "Bisedë mes hekurash", dialogu i dy figurave të shquara të kombit tonë, Ismail Kadare dhe Ukshin Hotit, njëri ndër të cilët vazhdonte të ishte ende i burgosur politik në burgjet serbe, për më tepër, si cilëson Kadare, i burgosuri politik më i rëndësishëm i kohës në trevat euroatlantike.

Natyrisht, është një dialog viganësh të mendimit dhe të shëmbëlltës së kombit, në të dy anët e kufirit shqiptar, në të cilin përshkëndijon madhërisht vetëdija kombëtare, e shkuara dhe e nesërmja, gjithnjë nën dritësimin e mendimit politik.

Ajo që më befasoi më tej është jo vetëm kujdesi i shkrimtarit tonë të shquar, Kadare, për zhvillimin e një bisede të pazakontë, por fillesa e këtij libri, që përbën edhe qëllimin kryesor të dialogut. "Ky libër e ka zanafillën në përpjekjen për lirin nga burgju të Ukshin Hotit", kështu shkruan Kadare në rreshtin e parë të fillësës dialogjane.

Kjo ndodhte pasi Kadare kishte dërguar një seri letrash institucioneve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, ministrave të Punëve të Jashtme të vendeve kryesore perëndimore, dhe pastaj, vjen ky dialog në tri gjuhë, shqip, frëngjisht dhe anglisht, për të qenë më efikas dhe për të kushtrimuar opinionin publik ndërkombëtar. Këtë e ka bërë një njeri i vetëm, të cilin kur e pyeta tre javë më parë, më tha se gjithçka ishte nisur nga instinkti i shkrimtarit, i kolegut, i nderimit dhe i përqsjes së një kombi ndaj një personaliteti të shquar.

Kur e mbylla faqen e fundit të këtij libri - dialog, mendova dhe ndjeva keqardhje:

Një njeri i vetëm, ndonëse i përmasave të njohura në të gjithë botën, ka bërë aq sa ka mundur për fatin e mendimtarit filozof më të shquar të kombit. Ka bërë atë që i ka lejuar fusha e tij, njohjet, emri. Po të tjerët çfarë kanë bërë dhe

çfarë kemi bërë për Ukshin Hotin? Pak, ose aspak. Nga mungesa e njohurisë, nga hallet, nga smira, nga mendimi se ai do të vijë dhe do të përmbysë një elitë të kërrusur, të mjerë, amorfe?

Ku ishte Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Akademia e Shkencave të Kosovës, qeveria e shtetit shqiptar londinez, "liderët presidencialë dhe qeveritarë të Kosovës" që kishin shpallur veten president e kryeministër? Ku mbetën ata? Po apelet e tyre ku janë?

Përse në Rambuje nuk vendosëm kusht që Ukshin Hoti të ishte pjesëtar i bisedimeve në trupën përfaqësuese të Kosovës apo kishim frikë nga mendja e tij brilante?

Një shkrimtar i shquar ka bërë i vetëm më shumë se gjithë ne të tjerët... më shumë se institucionet e luftës dhe të paqes, më shumë se akademitë dhe universitetet, më shumë se qeveritë dhe liderët...

Ukshin Hotin e vrau regjimi policor serb. Ai qëlloi mbi të. Heshtja jonë nuk shfaqëson askënd.

Dialogu i dy titanëve dëshmon se çfarë i mungon sot Kosovës me mungesën e njerit prej tyre.

Të atij që ishte në burg.

Që bëri burg për lirinë e Kosovës.

Nuk dua të shkruaj sot për zemërimet e Kadaresë me figura të njohura të Kosovës, të politikës apo të artit. Në një rrugëtim kaq të gjatë është e natyrshme të ketë ndodhi të tilla. Në librin tim, që do të botohet jo shumë larg, me titullin e tanishëm, të përkohshëm, "Kadare, i oborrit apo i lirisë" jam ndalur më gjatë në ndërlidhjen mes tij dhe Kosovës, ashtu si edhe në raportet e shkrimtarit me shtetin, diktaturën, qenësinë e veprës së tij dhe kohën që e ka shoqëruar.

Gjithmonë te Kadare, përshtypja e parë, kur është fjala për Kosovën, vjen nga tejkshkimi i jashtëzakonshëm i ngjarjeve dhe e dyta, nga madhështia. (Fund)

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kiesłowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kiesłowski, i ndërthurur me një egzgjenezë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kiesłowski, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kiesłowski dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

ÇMIMI: 5.99 €



AGRON SHALA

DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kiesłowski

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚŁOWSKI



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



Daut Dauti

NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Besa dhe Prishtina ndajnë mejdantin në Pejë



PRISHTINË, 26 SHKURT - Në fundjavë luhen ndeshjet e ardhshme në kuadër të kampionatit të Kosovës në hendboll. Në Superligën A të hendbollistëve kryendeshja zhvillohet të shtunën nga ora 18:00 në Pejë, ku takohen Besa Famgas dhe Prishtina. Është kjo ndeshja e javës së 20 kampionale, përkatësisht e javës së dytë në Superligën A. Besa udhëheq në tabelë me 38 pikë, pasi i ka fituar të gjitha ndeshjet e deritashme. Ndërsa Prishtina është e dyta me 31 pikë dhe synon t'i afrohet Besës me pikë. Sot (e shtunë) është edhe ndeshja Vëllaznimi - Kastrioti (19:00), kurse Drenica e Trepça luajnë të dielën prej orës 17:00. Të shtunën janë edhe ndeshjet e para të Superligës B, përkatësisht takimet e javës së 19 kampionale. Derbi i madh luhet në

Vushtrri në mes të Vushtrrisë dhe Llapit, të shtunën nga ora 14:30. Nga ora 17:00 takohen Zhegra e Prizreni. Në Ligën e Parë të hendbollistëve është java e 11-të. Samadrexha-KEK-u (19:00) dhe Drita-Lepenci (19:00) janë ndeshjet e së shtunës. Ulpiana-Vjosa (12:00) dhe Deçani-Dukagjini (13:00) luhen të dielën, ndërsa ndeshja Istogu-Rahoveci është të hënën nga ora 19:30 në Rahovec.

Vushtrria sfidon Istogun

Istogu-Vushtrria është kryendeshja e javës së 14-të në Superligën e Kosovës në hendboll në konkurrencë të fermave. Kjo ndeshje luhet të shtunën nga ora 18:00. Istogu ka fituar 13 ndeshjet e deritashme dhe udhëheq në tabelë me 26 pikë, kurse

skadra e Vushtrrisë është e dyta me 24 pikë, ndërsa ka 12 fitore e një humbje. Pra humbjen e vetme e ka nga istogaset. Në vitet e fundit shumë prej ndeshjeve të këtyre dy skuadrave kanë ofruar hendboll të mirë dhe rivalitet. Për ndeshje interesante shpresohet edhe këtë herë. Të shtunën janë edhe ndeshjet Shqiponja-Drita (13:00), Vjosa-Kastrioti (19:00), Vëllaznimi-KEK-u (16:30) dhe Prishtina-Jusuf Gërvalla (16:00). Ferizaj-Samadrexha luhet të dielën nga ora 16:00 dhe përmbyll xhiron e 14-t. Në Ligën e Parë të hendbollistëve të shtunën janë dy ndeshje të javës së tetë: Trepça-Prizreni (14:00), CLICK-Llapusha (14:00). Ndeshja Deçani-Dukagjini është të dielën nga ora 14:30.

SHKURT

Fidan Hamiti emërohet drejtor sportiv i KB Prishtina

Fidan Hamiti është emëruar drejtor sportiv në KB Sigal Prishtina. Ky vendim është marrë të premten, kur bordi i klubit kryeqytetas vendosi që Hamitin t'ia besojë këtë detyrë. "Sot bordi i klubit vendosi ta emërojë Fidan Hamitin drejtor sportiv të klubit. Fidani, ish-basketbollist dhe menaxher i suksesshëm në institucione të ndryshme, do t'i bashkëngjitet ekipit dhe të përkujdeset për mbarëvajtjen e pjesës sportive të klubit në sfidat e radhës. Fidanit i urojmë punë të mbarë dhe vazhdim të sukseseve të klubit në të gjitha kompeticionet", thuhet në njoftimin e KB Prishtina.

Januzaj: Hazardi është një nga lojtarët më të mirë në botë

Futbollisti me prejardhje nga Istogu, Adnan Januzaj, beson ende se Eden Hazardi është një nga lojtarët më të mirë në botë. "Ai është një nga lojtarët më të mirë në botë", ka thënë Januzaj. "Njerëzit këtu në Spanjë ndoshta ende nuk e kanë parë Edenin e vërtetë, por ata e njohin mirë kush është ai. Për mua, ai është një nga më të mirët në botë. Nuk ka dyshime. Hazardi do të ketë suksese në La Liga", ka deklaruar Januzaj.

Ibrahimi nënshkruan kontratë profesionale me Leipzigun

Talenti i ri i futbollit, Mehmet Ibrahimi, ka nënshkruar kontratë profesionale me klubin e Red Bull Leipzigut. Kjo është bërë e ditur nga klubi gjerman përmes një njoftimi në faqen zyrtare. Mehmet Ibrahimi ka nënshkruar kontratë të vlefshme deri më 2022. 18-vjeçari është pjesë e Leipzigut që nga korriku i vitit 2017. Në sezonin 2019/20 ai është paraqitur te grupmoshat U17, duke shënuar gjashtë gola në 15 ndeshje. Gjatë atij sezoni Ibrahimi ka luajtur në katër ndeshje në Bundesliga për grupmoshat U19. Mesfushori me prejardhje nga Kosova ka zhvilluar nëntë paraqitje edhe për të rinjtë e Gjermanisë (U16 dhe U17).

Dënohen Drenica dhe trajnerët Devolli - Mustafa

PRISHTINË, 26 SHKURT - Komisioni Disiplinor i shkallës së parë i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) e ka nderuar skuadrën e Drenicës me 1 000 euro me arsyen se klubi kuqezi ka bërë lëshime në organizmin e ndeshjes ndaj Besës e cila u zhvillua më 25 shkurt në terrenin me bari sintetik në Drenas.

Komisioni Disiplinor, po ashtu, ka dënuar edhe trajnerin Bledar Devolli dhe ndihmëstrajnerin Skënder Mustafa. Devolli është dënuar me ndalesë në ushtrimin e funksionit të trajnerit në klub për dy ndeshje zyrtare, me arsyen se pas përfundimit të ndeshjes kundër Besës hyn në fushë dhe i frustruar

nga rezultati i ndeshjes ofendon dhe tenton të konfrontohet me zyrtarët dhe lojtarët e skuadrës mysafire. Ndërsa Mustafa është dënuar me ndalesë të ushtrimit të funksionit të trajnerit dhe detyrave të tjera në klub për tri ndeshje zyrtare për shkak të sjelljes jospportive ndaj futbollistit kundërshtar Agon Xhaka.



Munishi: Të ndalohet termi 'trajnerët nga Shqipëria'

PRISHTINË, 26 SHKURT - Trajneri Ismet Munishi ka reaguar me anë të një postimi në profilin e vet zyrtar në rrjetin social në "Instagram", ku kërkuar të ndalet termi "trajner nga Shqipëria" sepse të gjithë jemi nga Shqipëria dhe të gjithë ne kemi emër dhe mbiemër. "Zgjedhja e trajnerit është

individuale dhe i përket klubit ose presidentit. Mund të jetë nga India, Maqedonia e Veriut, Zvicra apo Shqipëria etj. Ai trajner ka emër dhe mbiemër karrierë, personalitet etj. Personalisht po më pengon termi 'trajnerët nga Shqipëria'. Duhet të jetë termi 'filan trajneri'. Për sulmet që po

marrin kolegët e mi nga një pjesë e Shqipërisë duhet të reagojë edhe Shoqata e Trajnerëve. Termi 'trajnerët nga Shqipëria' vjen nga disa individë të cilët prej ambicies personale dëmtojnë shumëçka. Trajnerë nga Shqipëria jemi të gjithë nëse nuk e keni ditur, sepse të gjithë

jemi shqiptarë dhe askush nuk na ndalon të punojmë më shumë e të bëhemi trajnerë të mirë nga Shqipëria. Stop termit trajner nga Shqipëria! Trajneri ka emër", ka shkruar Munishi. Në Superligën e Kosovës aktualisht trajnerë nga Shqipëria janë Klodian Duro



me Feronikelin dhe Bledar Devolli me Drenicën.

Përballje 'ferri' në Ligën e Evropës, Unitedi përballë Milanit

NYON, 26 SHKURT - Goglat e hedhura në Nyon të Zvicrës i vendosën kuqezinjtë përballë Manchester Unitedit me ndeshjen e parë që do të luhet në "Old Trafford" të enjten e 11 marsit. Ajo në mes të Manchester Unitedit dhe Milanit është sfida më e fortë e këtij raundi në të cilin nuk mungojnë përballjet interesante. Arsenalit do t'i duhet të udhëtojë drejt Pireut



për t'u përballur me grekët e Olympiacos me ndeshjen e parë që do të luhet në Athinë. Roma do t'i sfidojë ukrainasit e Shakhtar Donetskut, ndërkohë që Tottenhami do të ketë përballë Dinamon e Zagrebit. Për Ajaxin shorti u tregua disi

më bujar pasi e vendosi kundër zvicranëve të Young Boys, ndërkohë që Villareali do ta sfidojë Dynamon e Kievit. Dy përballje disi më të baraspeshuara konsiderohen ato Granada-Molde dhe Slavia Pragë-Rangers.

Raundi i 1/8 në Ligën e Evropës:

Ajax - Young Boys
Dynamo Kyiv - Villarreal
Roma - Shakhtar Donetsk
Olympiacos - Arsenal
Dinamo Zagreb - Tottenham
Manchester United - Milan
Slavia Praha - Rangers
Granada - Molde

S'ka të ndalur Brooklyni, regjistron fitoren e tetë rresht

ORLANDO, 26 SHKURT - Brooklyn Nets nuk ndalet duke e regjistruar fitoren e tetë radhazi, teksa mundi thellë ekipin e Orlando Magicut. Duke lënë mënjanë periodën hapëse, Nets dominoi në pjesën e mbetur të takimit, duke udhëhequr gjatë gjithë kohës në rezultat. Brooklyni e mbylli pjesën e parë me epërsinë e 18 pikëve. Gjërat precipituan në pjesën e dytë dhe morën përmasa akoma më të mëdha për vendasit, që në çastet e fundit madje prekën edhe avantazhin e 40 pikëve. Fitorja e dytë në po kaq përballje në gjashtë javët e fundit dhe e treta radhazi për skuadrën e Brooklynit në përballjet ndërmjet tyre. Falë suksesit 129-92 Netsi po shijon një ecuri pozitive që i mungonte këtij "franchise" që nga viti 2006, për më tepër ekipi i drejtuar nga Steve Nash ia doli mbanë për ta siguruar fitoren e gjashtë rresht pa sulmuesin kryesor Kevin Durant. Kyrie Irvingu e mbylli takimin me 27 pikë e 9 asistime për më shumë se gjysmë ore lojë, ndërsa James Harden e ndihmoi skuadrën e tij me 20 pikë, 9 topa të rikuperuar dhe 7 asistime. Në këtë mënyrë Nets përmbirësoi akoma më tepër



statistikat duke ngushtuar ndjeshëm diferencën me kryesuesit e Philadelphia 76ers. Brooklyni pozicionohet në vendin e dytë në Lindje, me 22 fitore e 12 humbje. Netsi kuotohet si favoriti nga "bookmakers"-at për të triumfuar sivjet në këtë konferencë, sidoqoftë për momentin ekipi i Brooklynit mban vendin e dytë edhe në Divizionin e Atlantikut sepse, siç dihet, 76ers dhe Nets bëjnë pjesë në të njëjtin grup, raporton "Supersport". Vetë "franchise" nga Pennsylvania regjistroi fitoren e katërt në pesë ndeshjet e fundit, teksa mposhti pa shumë vështirësi në shtëpi ekipin e Dallas Mavericksit. Ekipi teksan udhëhoqi 15-13 dhe 18-16, megjithatë këto ishin edhe dy rastet e vetme kur miqtë e panë

veten në avantazh në këtë takim. Phila shkoi në pushimin mes pjesëve me epërsinë e 16 pikëve, gjithsesi në vazhdim skuadra e drejtuar nga trajneri veteran Doc Rivers administroi me qetësi avantazhin, për ta fituar krejt ndeshjen me shifrat 111-97. Në "Wells Fargo Center" spikati sërish sulmuesi nga Kameruni, Joel Embiid, me 23 pikë e 9 rebounde, ndërkaq vendësit e kufizuan yllin sloven Luka Doniq në vetëm 19 pikë. Te 76ers Ben Simmons dhe Seth Curry e mbyllën mbrëmjen me nga 15 pikë secili, ndërsa veterani Dwight Howard nga stoli kontribuoi me 14 pikë e 8 topa të rikuperuar. Philadelphia aktualisht udhëheq në Lindje me 22 fitore e 11 humbje, por 76ers kanë edhe një ndeshje për të zhvilluar krahasuar me ndjekësit më të afërt të Brooklynit Netsit.

REZULTATET

Milwaukee Bucks - New Orleans Pelicans	129 - 125
Denver Nuggets - Washington Wizards	110 - 112
Memphis Grizzlies - Los Angeles Clippers	122 - 94
Brooklyn Nets - Orlando Magic	129 - 92
New York Knicks - Sacramento Kings	140 - 121
Philadelphia 76ers - Dallas Mavericks	111 - 97

SHKURT

Duka: Reja nuk largohet nga Shqipëria

Zërat se Edi Reja mund ta marrë drejtimin e Napolit janë hedhur poshtë nga presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka. Ai i është përgjigjur interesimit të mediave italiane, duke përjashtuar kategorikisht mundësinë që tekniku i Shqipërisë të zëvendësojë në bankinën napolitane Genaro Gattuso, qoftë edhe përkohësisht. "I kam dëgjuar këta zëra, por nuk di asgjë. Napoli nuk më ka kontaktuar dhe Reja nuk më ka folur për mundësinë e një pune të dyfishtë si trajner i kombëtares dhe i Napolit. Por e nënvizoj se është një mundësi që e përjashtoj në mënyrë kategorike. Nuk mund të jesh trajner njëkohësisht në një kombëtare dhe një skuadër klubi. Nuk mund të ndodhë", ka thënë Duka për radio "Kiss Kiss Napoli".

Khaka, pas kualifikimit: Dëshirë e madhe, fitore e madhe

Skuadra e Arsenalit është kualifikuar në rrethin tjetër të Ligës së Evropës. "Topçinjtë" siguruan kualifikimin për në raundin e 1/8 së finales, pasi mposhtën Benficën me rezultat 3-2 (1-1). Pas ndeshjes ka reaguar lojtari me prejardhje nga Kosova, Granit Xhaka. "Po pra, për këtë jam duke folur. Zemër e madhe, dëshirë e madhe, fitore e madhe", ka shkruar Xhaka, i cili në këtë takim luajti 90 minuta dhe bëri një paraqitje fantastike.

Operohet Hendersoni

Kapiteni i Liverpoolit, Jordan Henderson, iu nënshtua një operacioni në "adductor", pasi u dëmtua javën e kaluar në ndeshjen e Premierë Ligës kundër Evertonit. Mesfushori anglez menjëherë do të fillojë një program rehabilitimi, por kthimi i tij në fushë përjashtohet deri pas ndërprerjes ndërkombëtare në mars, kur kombëtares angleze do t'i luajnë ndeshjet e para kualifikuese. Trajneri Jurgen Klopp duhet të bëjë edhe pa të, ndërkohë që disa dëmtime të tjera me peshë i kanë penalizuar së tepërmi "Reds", për të dalë nga gara për titull qysh tani.

Covidi 'godet' Torinon

Torino është goditur shumë nga Covid-19 këto ditë, ku kanë dalë 8 raste pozitive. Klubi i Torinos përmes një komunikate me shkrim ka njoftuar për një rast tjetër pozitiv. "Klubi i Futbollit Torino njofton se nga analizat e kryera natën e kaluar doli një rast i ri me Covid-19. Prandaj, edhe sot, në dispozicion të autoritetit kompetent shëndetësor lokal, ekipi nuk do të mbajë asnjë seancë stërvitore", thuhet në njoftimin e skuadrës së Torinos. Për shkak të rrezikut se mund të infektohen edhe klubet e tjera, ndeshja me Lazio, e paraparë të luhet me 2 mars, mund të shtyhet.

Napoli po e mendon rikthimin e Sarrit

Skuadra e Napolit është duke e menduar rikthimin e trajnerit Maurizio Sarri në sezonin 2021-22. Tekniku toskan kaloi tre sezone në këtë klub midis viteve 2015 dhe 2018. Ai ishte afër fitimit të "Scudetos" në 2017-18, duke i dhënë fund sezonit të Serisë A me 91 pikë. Ai më pas u transferua në Chelsea dhe Juventus, ku fitoi një Ligë të Evropës me anglezët dhe një titull në Serinë A me "Bianconerët". "Zonja e Vjetër" e shkarkoi atë verën e kaluar pasi ishin eliminuar nga raundi i 16-të i Ligës së Kampionëve nga Lyonit. Gennaro Gattuso pritet të shkarkohet kur të përfundojë ky kampionat.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:316/1

Dt:26.02.2021

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Neni 4 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr.05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

Ri-SHPALLJE E KONKURSIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Shkollën e Mesme të Makinerisë "Shtjefën Gjeçovi", në Prishtinë për vitin shkollor 2021/2022

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
ShML	Sh.M.M "Shtjefën Gjeçovi", në Prishtinë	Prishtinë	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e Gjuhës dhe letërsisë shqipe 20 orë mësimore; Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e Edukatës Fizike dhe shëndetësore me 10 orë mësimore;	Zëvendësim deri në kthimin e mësimdhënësit nga pushimi pa pagës Vend i lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe procese mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 7 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merrren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Shkollën e Mesme të Makinerisë "Shtjefën Gjeçovi", në Prishtinë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.



SHPREHJE INTERESI

Me datë 10 shkurt 2021, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit ka shpallur dëgjimin publik https://kodeproject.org/wp-content/uploads/2021/02/Second-Public-Consultation-for-Unconnected-Towers_SQ.docx.pdf për lidhjen e Pirgjeve (BTS-ve) me fiber optik. Dëgjimi publik ka zgjatur deri me 18 shkurt 2021. Ky ka qenë edhe parakushti i fundit dhe më pas Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, procedon me hapjen "Thirrje për Aplikim sipas skemës së GRANTE-ve për Financimin e Infrastrukturës Dixhitale".

Telekomi i Kosovës SH.A., shpreh interesin e tij për të aplikuar në "Thirrje për Aplikim sipas skemës së granteve për Financimin e Infrastrukturës Dixhitale", e cila pritet të publikohet së shpejti nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, si njëra nga komponentët e Projektit të Ekonomisë Dixhitale të Kosovës (KODE). Për të aplikuar në skemën e granteve të lartcekura, Telekomi i Kosovës SH.A. ka nevojë për bashkëpunëtorë, të cilët do të ishin në gjendje të ofrojnë kryerjen e disa punimeve/furnizimeve/shërbimeve, që nuk mund të realizohen nga vet Telekomi.

Projekti KODE financohet nga Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (IDA), dhe informata më të detajuara për projektin mund të gjenden në <https://kodeproject.org>

Telekomi i Kosovës SH.A. në cilësinë e Aplikuesit për GRANT, përmes këtij publikimi, fton të gjithë bashkëpunëtorët potencial për bashkëpunim të mundshëm, të cilët do të jenë në cilësinë e nënkontraktorit.

Për t'u bërë bashkëpunëtorë potencial te Telekomit, operatorët ekonomik fillimisht duhet të plotësojnë disa kushte, si në vijim:

- Duhet të dorëzojnë Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit (Kopje).
- Të dorëzojnë listën e referencave për punët/furnizimet apo shërbimet e kryera në fushën e telekomunikacionit me theks në ndërtimin e rrjetave optike.
- Listën e personelit në dispozicion për realizim të projektit.
- Vërtetimin e Administratës Tatimore, që nuk është në vonesë të pagesës së tatimeve
- Certifikatën nga Gjykata Themelore, që nuk është në procedure të falimentimit dhe likuidimit.

Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve potencial do të bëhet duke pasur parasysh plotësimin e kërkesave të mësipërme si dhe seriozitetin e kompanisë që aplikon, ku përparësi do të kenë kompanitë të cilat kanë punuar në fushën e Telekomunikacionit në të kaluarën.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen përmes e-mail adresës: KODE@kosovotelecom.com, ndërsa për pyetje apo sqarime eventuale mund të drejtoheni gjithashtu në e-mail adresën KODE@kosovotelecom.com

Afati i fundit për dorëzim të aplikacioneve është data: 11 mars 2021, në ora 24:00.

Vetëm operatorët ekonomik që i plotësojnë kushtet dhe konsiderohen të përshtatshëm do të ftohen për të diskutuar lidhur me mundësitë e ftesës për bashkëpunim të mëtutjeshëm me Telekomin e Kosovës në këtë projekt, respektivisht aplikimi në skemën e GRANTE-ve sipas thirrjes së lartcekur.



K.R.U. "Drini i Bardhë" SHA
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85
www.krudinibardhe.com

Në bazë të Ligjit për Ndërmarrje publike Nr.03/L-087, Kodit të etikës dhe qeverisjes korporatave mbi Ndërmarrjet Publike, statutit të Kompanisë dhe rregullores për sistematizimin e vendeve të punës, Kryeshefi Ekzekutiv i KRU "Drini i Bardhë" Sh. A, me datën 26.02.2021 vendosi të shpallë këtë:

KONKURS

Për plotësimin e pozitës:

1. Zyrtar i/e Prokurimit.

I përgjigjet: Kryeshefit Ekzekutiv.

Vendi i Punës: Pejë. Një pozite (1).

Paga: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Kohëzgjatja e emërimit: me kohe të caktuar 120 dite.

Detyrat e punës:

Udhëheqja më procedurave të prokurimit si dhe përgjegjësia për zbatimin e procedurave të prokurimit sipas ligjit ne fuqi për prokurim, në Kompani.

Kushtet për lidhjen e marrëdhënies së punës:

- ✓ I Certifikuar për punë të prokurimit, certifikatë valide për prokurim
- ✓ Përvojë pune në prokurim 3 (tri) vite.

Aplikacionit për pozitën e Zyrtarit/ës të prokurimit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

Kërkesën,
Kopjen e letërnjoftimit,
Certifikatën e prokurimit,
Dëshminë e përvojës së punës.

Data e mbylljes së konkursit: konkursi është i hapur 7 ditë kalendrike nga dita e publikimit.

Procedura për aplikim:

Aplikacionet e kompletuara sipas këtij konkursi dërgohen në Zyrën e Asistentes Administrative NP. K.R.U "Drini i Bardhë" SH.A në adresën Rr." Mbretëresha Teutë" Nr.85 Pejë, konkursi është i hapur nga data e publikimit ne gazetë, aplikacionet mund të dorëzohen nga ora 8:00 deri në ora 16:00.



MITROVICA
KOMPANIA UJESJELLESË RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

D P A

Departamenti për punë administrative

Mitrovicë /Nr.

Kompania Rajonale Ujësllësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MF-NR.07/2017, me datën 26.02.2021 mori vendim për të shpallë:

KONKURS

(Per plotësimin e vendeve te lira te punës, punë provuese 6 muaj me mundësi vazhdimi)
I.Gjashtë (6) Rojtar

Pershkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Bënë ruajtjen e objektit dhe hapësirave përreth,
 - Ruan automjetet që të mos vijë deri te thyerja, dëmtimi dhe vjedhja e tyre,
 - Mban evidencën e hyrjes-daljes të automjeteve dhe mjeteve tjera nga lokalet e kompanisë,
 - Të ketë kujdes në evitimin e shkaqeve të zjarrit si dhe në shuarjen e tij nëse vjen gjerë te zjarri,
 - Mban evidencën e hyrjeve dhe daljeve të personelit të kompanis si dhe palëve të tjera,
 - Punët dhe detyrat e punës i kryen në katër ndryshe,
 - Në rast vizites nga ana e udhëheqësit i raporton mbi gjërat e të vërejtura gjatë punës së tij,
 - Kryen edhe punë tjera në këtë vend pune sipas urdhërit të udhëheqësit të kompanisë.
- Përgaditja Shkollore : Shkolla fillore.

Paga mujore :sipas Rregullores mbi ndarjen e te ardhurave.

Dokumentat e kompletuara të cilat duhet të përfshijnë letren përcjellëse, biografin tuaj (CV-në), kopjen e diplomës përkatëse e noterizuara, referencat dhe certifikatat- të lindjes, , të mos jetë nën hetime dhe i dënuar, letërnjoftimi kopja, dëshmi mbi përvojën e punës etj.

Dokumentacioni dorëzohet i fotokopjuar dhe i njëjti nuk u kthehet aplikantëve.

Afati për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit në të përditshmen Epoka e re.

Dokumentet që nuk janë të kompletuara sipas konkursit nuk do të shqyrtohen.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në:

Zyra Nr.6

Drejtoria e KRUM.

Rr. Bislam Bajgora pn.

Mitrovicë



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova/ Republika of Kosovo
Komuna Dragash/Opština Dragaš/ Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM DRAGASH



Nr.13/103

Datë:26.02.2021

Dragash

Në pajtim me autorizimet dhe përgjegjësit të cilat i ka Drejtoria i Drejtorisë për Arsimit dhe mbështetur në Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Drejtoria i Drejtorisë së Arsimit, merr këtë:

VENDIM

Për anulim të konkursit për mësimdhënës nr.13/90 të datës 23.02.2021

1. Anullohet procedura e rekrutimit për konkursin e shpallur publik **nr.13/90**, të datës: **23.02.2021**, i publikuar në Gazetën Epoka e Re me datë: **25.02.2021**.
2. Anulimi i konkursit nga pika 1 e këtij vendimi behët meqë kanë ndryshuar procedurat e rekrutimit, ky konkurs shpallet sipas procedurave ne fuqi, kjo procedur e rekrutimit **Anullohet** sipas pikes 1 të këti vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

Me respect,

Drejtori i Arsimit në Dragash

MSc.Vloran Cenaj

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "KRASNIQI LAW" SH.P.K. ka marrë vendim të shuaj biznesin me nr. 811510496 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "KRASNIQI LAW" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 811510496, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "KRASNIQI LAW" L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 811510496, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

